



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 12(426)

DHJETOR 2023

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIJOBVL.ORG

FESTA



SHQIPËRIA 111 VJET PAVARËSI

Akti i Shpalljes së Pavarësisë përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar

FAQE 3

MESAZHI




PUTHJA E FLAMURIT TONË KOMBËTAR NGA ABDURRAHIM BUZA

Nga Xhemal Meçi

FAQE 2

DITELINDJA

Kryesia e OBVL uron anëtarin e saj në ditëlindjen e tij të 88-të



SHUAIP METHASANI, VETERANI QË RREZATON MIRËSI DHE VLERA

Nga Halil Rama

FAQE 6

Kryetari i OBVL kolonel Sotir Budina vlerësohet me certifikatë mirënjohje për kontributin gjatë LANÇ

79 VJETORI I ÇLIRIMIT, NDEROJMË HERONJTË QË LUFTUAN PËR LIRINË E ATDHEUT

EDITORIAL

GRATË DHE VAJZAT NË UNIFORMË USHTARAKE

Halil RAMA*

Gratë dhe vajzat në uniformë ushtarake, jo vetëm në nivel kombëtar, por në nivel rajonal dhe global duhet të ngrënë fuqishëm zërin që ato të jenë të vlerësuar dhe të meritojnë vendin që u takon. Ky qe mesazhi që Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Zëvendëshef i Shtabit të Përgjithshëm të FA përcolli në konferencën “Eomen in Uniform Association” që u mbajt në Tiranë nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, me iniciativë të Atasheut Ushtarak Britanik në Tiranë nënkolonel Timothy Eight-Boykot, në kuadër të programit “Eomen in Uniform Association”. Qëllimi i zhvillimit të kësaj konference të rëndësishme në kuadër të fuqizimit të rolit të gruas nën uniformë, ku merrnin pjesë edhe Ambasadori Britanik në Mal të Zi, zoti Daën McKen dhe zry. Mia Marzouk, zëvendës ambasadore e Britanisë së Madhe në Shqipëri ishte diskutimi mbi fuqizimin e rolit të grave të përkushtuara që punojnë në Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit në mënyrë që ato të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

VIJON NE FAQEN 3

OPINION

OKB -ja DHE MBROJTJA E SIGURISË DHE PAQES NË BOTË

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 15

ESSE

SALARI GRYKË E TUFANIT

Neki ÇAKO

FAQE 14

DOSSIER

ZBULIMI USHTARAK SHQIPTAR, HISTORITË E PATREGUARA

GANI ELEZI
FAQE 13, 14



• Në këtë ditë të veçantë, kryebashkiaku Veliqaj nderoi 10 veteranë të LANÇ “për kontributin e pashembullt në luftën për liri, mbrojtjen e atdheut nga pushtuesit nazifashistë dhe transmetimin te brezat e rinj, të vlerave, sakrificave dhe vetëmohimit të treguar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare”

FAQE 13

Tefta Cami: T’i mbrojmë vlerat dhe gjakun e derdhur gjatë LNÇ

SUPLEMENTI LETRAT



Njeriu i mirë, njeriu i ditës në qendër të publicistikës letrare të Halil Ramës

FAQE 9

Sakip CAMI – Shkrimtar&publicist

CIKËL ME POEZI NGA Bashkim KOZELI

FAQE 8

HISTORIA

80 VJET NGA KRIJIMI I BRIGADËS IV SULMUESE

FAQE 4

CEREMONIA

ESHTRAT E DËSHMORIT DUSHAN SHAMETAJ, NË VARREZAT “DËSHMORËT E KOMBIT”

FAQE 7

KUVENDI

ÇLIRIMI I PRIZRENIT NË NJË DATË KYÇE TË ANTIFASHIZMIT

Nga Bashkim Hisari

FAQE 5

GJAKOVË – PËRKUJTOHEN DITA E ÇLIRIMIT DHE FORMIMI I BRIGADËS VII SULSMUESE KOSOVARE

Afrim Deva

FAQE 5

145 VJETORI I RENIES

HITO ZENEL HITAJ, KAPEDANI I LABËRISË QË NUK E TREMBI EKZEKUTIMI

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 10

NDERIMI

ORGANIZATA E DËSHMORËVE NË FAMILJEN E AFRIM BUNJAKUT

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

FAQE 7

IN MEMERIAM

LAMUMIRË ELEZ DERVISHI, VETERANI 90 VJEÇAR NGA KRYEZIU I PUKËS

Nga Sefer PASHA

FAQE 11

MESAZHI

Vizita mbresëlënëse e Piktorit të Popullit dhe nënës heroine Bije Vokshi në Pukë

Nga Xhemal Meçi*
Sstudies & "Mjeshtëri i Madh"

Ndërsa Shprehej plot emocione Piktori i thimjur, Profesori i nderuar. Abdurrahim Buza, (sa i mbusheshin sytë me lot) puthja e parë e Flamurit tonë Kombëtar në Pukë më ka mbetë si një nga kujtimet kryesore të jetës sime, se e kujtoj veten si ISA BOLETINI, që e puthi atje në VLORE, sapo ia solli ISMAIL QEMALI!

Sa herë them me vete: " Hajde, Abdurrahim, hajde, që e Puthë Flamurin Kombëtar për herë të parë në PUKË, si Isa Boletini në VLORE! Ai, në Jug e ti në Veri sa mbetet në Histori !!!

Mbas pushimit të drekës, Piktori buzagas kërkoi leje që të bënin një shetitje nëpër qytet, "Se po më pëlqen nga që paska ndryshue me godina të reja, rrugë të pastra, anësoret me lulishite e me gjelbrime dhe kurorën me pisha deri brenda në qytet, shto edhe këtë ajër të freskët dhe aromatik! Pra unë me Hidijen po shkojmë drejt shkollës së re 9 -vjeçare "MIGJENI", tue soditë edhe sfondin me malin e Krrabit (Monti Di Puka) në veri dhe në veriperëndim me Alpet krenare e borë - bardha mbi krye si plisat (kësulata) që mbajnë në krye ende malësorët tanë verë e dibër. Të duket se me këtë mënyrë malësorët tanë truplartë e syshqiponjë e bajnë me qëllimin e mirë për të tregue se ata janë vazhdimi i natyrshëm i Alpeve Shqiptare, i këtyre trojeve iliro-arbërore, ku të parët e tyre gjetën mbrojtje e guxim si Anteu mitologjik me tokën mamë".

Në mbrëmje e tregonte me entuziazëm e ngazëllim këtë mrekulli natyrore të maleve tona, fole të sigurta në shekuj! Po prapë,-nisit të rrëfjës - ajo që më bani mjaft përshtypje ishte se disa shkëmbenj kishin pamjen e fytyrës së Kreshnikëve, që ngjesheshin sup për sup me njëri- tjetrin, sukur donin të thonin kështu duhet të jenë të bashkuem shqiptarët, kështu si në shkëmbenjtë e këtyre bjeshkëve shekullore!

Ndërsa profesori i tregonte të gjitha këto plot entuziazëm, Fehmije Buza tundte kryet e gëzuar me mendimin se "Sa mirë bana që e binda të vinte me ne në Pukë! Po prit se do kesh edhe ma me pa e me tregue!"

"Edhe ne i pamë këto që tregoni Ju Profesor, ndrhyni me takt e dashamirësi Bije Vokshi: "Edhe ne, me Xhemajlin e Sabrijen time të dashtun shkuem kah "Pyjorja", siç i thokan këto prej kah i pamë ma të qarta e ndoshta ma madhshtore Alpet tona Shqiptare, por nuk dimë t'i tregojmë aq bukur siç i tregoni Ju. Për ma tepër unë pashë me habi Varrezat e Dëshmorëve të Pukës që i kishin vendosun në varre mermeri të bardhë, ashtu siç qenë edhe ata shpirtbardhë e zemërbardhë që luftuan dhe ranë për liri e për atdhe! Tue i pa kështu në radhë krahas njani - tjetrit, seç m'u lshue një dhimbje e përmallim për dëshmorët tanë atje në Kosovë; se shumë prej tyresh me mzi u duket varri. M'u lkundë trupi dhe u shkrehu tue ra me gjunjë mbi tokën e fortë, por Xhemajli me të shpejt më kapi për krahësh e filloi të më çonte ngadalë, tue më pyet në se u vrava,. Flimimisht m'u duk se nuk jam vra fare, por kur fillova të ecsha se ç' po ndjeja një dhimbje. Kur vuna dorën në gjunj, pashë se më paskan pasë dalë pak pikla gjaku, po faleminderës ZOTIT shpëtova mirë. Duket se më paska pasë ra të fiktë kur pashë sesa mirë i kishin vendosë Dëshmorët e Atdheut ashtu krahas njani - tjetrit në ato vorreza të bardha!"

-Pse po jau tund kryet, Zonja Shyhret, Xhemajlit e Sabrijes, se ato s'kanë faj, përkundrazi i falnderoi që ma banë atë Nder, që t'i shikoj këto vorreza, që do t'i kem shembull për në Kosovë! Do t'u tham ejani e shihni se si ka veprue një qytet i vogël si Puka në Shqipni me këtë vepër të madhe! Sigurisht ka ndihmue shteti. Fundja e ka për detyrë, se në themelet e Shtetit asht gjaku i Dëshmorëve të Atdheut!

-Pa na thuej Xhemajl si ma ke thanë një herë se si asht shpreh Fishta për Dëshmorët e Atdheut te "Lahuta Malësisë", se më duket se s'ka sesi thuhet ma mirë. He, thuje del! Por e mori përsëri fjalën Profesor: "Kam dëshirë ta them unë, se më kanë mbetun në mendje ato vargje lapidar, sapo i lexova nga libri i një prindi që e mbante në xhep:

"O ata t'lumt që dhanë jetën!/ O ata t'lumt që shkrin veten!/ Që për erz e nder t' Parëve!/ Që per nder te tan Shqiptarëve!/ e dhan jeten si me le...Ata kurr mos u harrojshin! / N' kangë e në valle por u kndojshin! / E njaj gjak që kanë dikue? Ban, o ZOT, që t'jet tu vlue/ për me ia xe zemrën Shqiptarit!/ Per kah vendi e gjuha e t' Parit!" ("L. M. Shkodër , 1937, f. 56.)

Për pak minuta ra një heshtje mallgjimi e trishtimi. Por, përsëri vazhdoi Profesori i pikturës: "Gjatë kalimit nëpër qytet nuk gjeta asnjë gjurmë migjennjane jete për

PUTHJA E FLAMURIT TONË KOMBËTAR NGA ABDURRAHIM BUZA



sa kishte krijuar e shkruar për malësorët e unshëm të Pukës me ka një gjysmë thesi misri, mbi shpinë. Po nuk pash as njeri të shtrinte dorën e të lypte: "Më fal diçka Zotni! Zoti t' dhashtë!"

Këtu në Pukë, ndryshe prej disa vendeve të tjera a qyteteve të mëdha nuk lypin,-s qaroi Sabria! E, pra në PUKË NUK LYPIN!! Pse profesor. ndërhyri Fehmija buzagas!

"Bile,- ja nisi si me ndrojtje të shtonte diçka Shyhreti, këtu në Pukë nuk asht se nuk ka vorfni. Vorfnia nuk zhduket përnjëheresh, por u duket vetja se lypsia asht poshttrim i vetvetes!" Profesor foli mendushëm: "Bravo zonja Shyhret, se e dhat mendimin e duhur! Bile këtu desha të dilja edhe unë, se për mue kjo trgon se kemi të bajmë me një trashigimi fisnikërie, të në popullit fisnik e krenar, që nuk e ka në shpirt Lypen.

Shyhreti që më shumë dëgjonte, mori përsëri zemër e shtoi: "... në Pukë, tue mos lyp kush, nuk dalin me lyp as dy familje jevgjish që jetojnë, këtu prej vitesh!"

Pra, vijoi profesori - Migjeni këtu në Pukë ka lanë vetëm kujtime e dashamirësinë për këtë popull të varfër e të përvuajun sa nuk thohet nga kush, veçse nga MIGJENI. Por Migjeni ishte i gjallë sot në kujtime, si shkolla e re dhe e bukur 11-vjeçare që mbante emrin "MIGJENI". Ndërsa shkolla e dikurshme, ku ka dhënë mësim Migjeni (prill 1936 deri në nëntor 1937) qenka kthyer në shkollë Muze - "SHKOLIA MUZE MGJENI" Pukë. Jo vetëm kaq, po e paskan shpallun " QYTETAR NDER TË BASHKISË; PUKË Hajde Pukë, hajde se na gëzove!",

Të nesërmen erdhi dhe i përshëndeti Qazim Bobolli. Qazim Bobolli ishte një prej tregtarëve gjakovar më punëtor dhe shunë komunikues e human me popullin dhe fshatrat për rreth, bile deri në Koman. Nuk kishte njeri të fliste ndryshe, veçse mirë. Me Bije Vokshin fliste pak i nervozuem se pse nuk i lejonin të vizitojshin vendlindjen e tyre, Gjakovën dhe të afërmit e tij. Se sa kam punue ju Hallë Bije e dini mirë. Si Kryetar i Këshillit NÇL për qytetin e Pukës, sa kosovarët i kam pritur e përcjellun si s'ka ma mirë. Bile, edhe Ju, Hall Bije ju kam pritur e përcjellë edhe me shoqet tuja. Nuk duhet harrue puna që kemi ba në ato kushte të vështira. Sapo kishte përfundue Lufta, kur na mungonin shumë gjana; kryesorja ushqimett. Fshatrat e Pukës ishin të varfëra për veti.

Në këto fjalë, që kishin krijuar një situatë disi të rënduar erdhi Sabria e tha, si gjithmon e qeshurr: "E kishim lënë të bënin një vizitë në Pallatin e Kulturës, ku po prisnin kur në sallën e koncerteve, i pari u ngrit "Artisti i Popullit" Ndue Shyti duke e falenderuar Profesorin A. Buza për vizitën e tyre! Të nderuarës BIJE VOKSHI, Ndue Shyti i drejtohet me shumë xhen-

tilensë: "Shumë e nderuara Hallë e Heroit të Popullit Asim VOKSHI! Asht nder i madh që na urdhëroni në Pukën tonë të vogël, po me mjaft jehonë për kulturën tonë Iliro- Arbërore të Komanit të famshëm si dhe në vatrën e "Ansambli Puka" që është bërë i njohur që nga Vietnami e Kina e largët dhe deri në Vienë, Romë, Paris, në veçanti te vëllezërit tanë kosovarë dhe arbreshët e Italisë. Më falni se sikur u lavdrova, se këto do t'i keni ndigjue edhe prej mbesës suej Sabrijes, e lidhur me origjinën e saj gjakovare, por e lindur e rritur në Pukën tonë që e don dhe e respekton si bijë pukjane, që ka nderue Pukën në Tiranë për 12 vjet në Liceun Artistk "Jordan Misja" si dhe në Institutin e Arteve të Bukura për Muzikë dhe tash po ia kthen Pukës nderet e bame me ndihmën që po i jep Ansambli "Puka" dhe mua veçanërisht me kulturën muzikore, për të cilën nuk e kam pas fatin e Sabrijes. Por edhe Ajo e ka për lavdatë që po e mëson prej meje çiftelinë me dy tela. Kështu,pra, Sabrije Nushi është 'Krenaria e Pukës', titull që Bashkia do t' ia jap së shpejti se e meriton.

Pastaj vazhduan urimet e mirëseardhjes prej: Drejtorit të Pallatit, Zotni Fran Vukaj - aktor e regjizor i mirënjohur. Po kështu koreografi e valltari i talentuar Riza Hoxha, fitues i disa çmimeve e diplomave në Festivale. Edhe Fran Pali, rapsod e instrumentist i mirënjohur brenda e jashtë atdheut, ndërtesues i violinës së parë shqiptare, që në vazhdim me shokët e tij të reparitit, sidomos Vitor Shahinin prodhuan 500 violina për shkollat e muzikës anë e kand Shqipërisë me firmën "MADE IN PUKA".

Ky prezantim që e bëri Sabria u mirëprit nga vizitorët e nderuar: Pktoti e Mësuesi i Popullit ABDURRAHIM BUZA, Hallë Bije Vokshi atdhetare e shquar dhe Bazë e LANÇ, përkrahëse dhe strehuese e Heroit të Popullit Qemal Stafa. Jo pa merita familjare atdhetare edhe Fehmije Buza e pranishme.. Nga pushtetarë e partiakët lokal nuk erdhi kush, se e morën si një veprim i Sabrijes e Xhemalit për të treguar lidhjet e tyre me figura të tilla të Shquara.

Shënim, Duhet të bëjmë një sqarim lidhur me vitin e vdekjes së të ndjerit Abdurrahim BUZA (Shkup, 1905- Tiranë 1986). E bëjmë këtë shënim se në gazetën PANORAMA, datë 8 Nëntor2023, f. 13 në njoftimin "PËRKUJTOHET "PIKTORI I POPULLIT" ABDURRAHIM BUZA shënohet gabim me ngatrimin e dy numërave të fundit nga 1986 në 1968! Këtë fakt e mbështesim kryesisht në FJALORI ENCIKLOPEDIK_SHQIPTAR, Tiranë ,2008, f. 348,,)

*Vazhdimi i pjesës së parë, botuar te " VETERANI", Nr, 11, 425, Nëntor 2023, f. 13)

FESTA

SHQIPËRIA 111 VJET PAVARËSI

Siç kishte njoftuar Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, më 28 nëntor, në shënjim të 111-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, u mbajt në Tiranë një koncert festiv.

“Festat e Nëntorit vijnë ndryshe këtë herë, me shqiptarët e mbledhur nga e gjithë Diaspora, që bashkohen në paradën e traditës në 28 Nëntor, në Sheshin Skënderbej, për të vijuar më pas me koncertin “Folk Fest”, ku e gjithë shqiptaria ngjitet në skenë me pjesëmarrjen e grupeve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Arbëreshët”, shkruan Rama.

Për herë të parë, në kryeqytetin shqiptar mbahet, “Parada e shqiptarëve”. Aktiviteti u zhvillua më 28 Nëntor në Bulevardin ‘Dëshmorët e Kombit’.

111 vjetori i pavarësisë së Shqipërisë u festua madhërisht në Vlorë, në të gjitha qytetet e Republikës së Shqipërisë dhe në hapësirën shqiptare kudo në botë.

Më 28 Nëntor 1912, Kuvendi Kombëtar i Vlorës shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Akti i Shpalljes së Pavarësisë përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Ai ishte fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar. Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës.

28 Nëntori i vitit 1912 shënon një kthesë his-

Akti i Shpalljes së Pavarësisë përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Ai ishte fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar



torike për popullin shqiptar, sepse nga njëra anë mori fund sundimi gati pesëshekullor i Perando-

risë Osmane, nga ana tjetër u krijuan kushtet e reja politike për të dalë nga prapambetja e madhe dhe për zhvillimin e tij më të shpejtë ekonomik, shoqëror e kulturor.

Shpallja e Pavarësisë ishte një fitore e madhe e shqiptarëve edhe kundër politikës antishqiptare të monarkive fqinje ballkanike, kundër synimeve e planeve të tyre për copëtimin e plotë të Shqipërisë. Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë ishte fitore e përbashkët për të gjithë popullin shqiptar dhe për të gjitha forcat që kishin marrë pjesë në luftën për çlirimin kombëtar, me pushkë dhe me penë.



GRATË DHE VAJZAT NË UNIFORMË USHTARAKE



Halil RAMA*

(vijon nga fq.1)

Objektivi i këtij aktiviteti ishte ndihma që u duhet dhënë grave në këto struktura që të kuptojnë më mirë rolet dhe aftësitë e homologëve të tyre në organizata/struktura të ngjashme si në nivel lokal ashtu edhe në rajon. Po ashtu në fokus ishte ndihma që u duhet dhënë grave në uniformë që të krijojnë kontakte të reja në këtë fushë të punës.

Në funksion të udhëtimit të tyre në karrierë femrat në uniformë duhet të mësojnë dhe dëgjojnë nga gra më me eksperiencë dhe detyra më të larta me qëllimin për të përmirësuar besimin e tyre dhe për të demonstruar/treguar se çështjet me të cilat përballen janë ndërkombëtare. Në panelin e parë “Sfidat e të qenit grua për mbrojtjen dhe sigurinë, duke përfshirë mënyrën se si të jesh një aleat efektiv”, gjeneralmajor Manushaqe Shehu argumentoi rolin e femrave në uniformë në Forcat e Armatosura, duke vënë theksin se në zbatim të Planit të Veprimit Kombëtar dhe atij të Ministrisë të Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë hapa të rëndësishëm për rolin dhe rëndësinë që kanë femrat në uniformë dhe për mbrojtjen e dinjitetit të tyre krahas burrave në uniformë.

Duke sjellë për pjesëmarrësit përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin e Barazisë Gjinore, numri dy i FA të RSH gjeneralmajor Manushaqe Shehu, theksoi me forcë se roli i femrës ushtarake është rritur ndjeshëm si në arsimim, trajnim, në promovim në detyra e gradë. “Femrat ushtarake sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atash ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra”, tha gjeneralmajor M.Shehu. Gjithashtu ajo i njohu pjesëmarrësit në panel edhe me hartimin e dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokument i cili është përgatitur disa vite më parë me asistencën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri. Në fjalën e saj ajo përmendi edhe disa shifra që tregojnë rritjen e pjesëmarrjes së femrave në FA. Aktualisht përfaqësimi i femrave ushtarake në FA është 15.07%. Nga këto oficerë femra 20.84%, nënoficerë femra 13.44 %, ushtarë femra 11.37% të numrit të përgjithshëm të femrave ushtarake. Ndërsa numri i punonjësve civil përbejnë 37.03 % dhe në total numri i femrave ushtarake dhe civile në FA përbejnë 20.12%. Po kështu ndjeshëm është rritur rekrutimi i femrave për tu bërë oficerë. Aktualisht në Akademinë e Forcave të Armatosura vetëm në bachelor dhe kursin e përgatitjes së oficerëve kemi 50 femra, nga këto 4 janë nga Kosova.

Ligji nr. 9970, datë, 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe gjithë aktet e tjera nënligjore në fuqi si: “Mbi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030” dhe “Planin e Veprimit”, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.202, “Planin

e Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2030 në FA”, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 651, datë 06.05.2022, të përgatitura në zbatim të Rezolutës 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara “Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë”, janë një bazë e shëndoshë për mbështetjen e femrës shqiptare në uniformë në Forcat e Armatosura, por gjatë punimeve dyditore të kësaj konference diskutantët sollën mjaft përvoja dhe praktika në vendet e institucionet e tyre, për të cilat – shprehet Gjenerale Shehu - një pjesë e tyre mund të merren në konsideratë në të ardhmen nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, me qëllim rritjen akoma më shumë të rolit dhe përgjegjësisë së femrës ushtarake në jetën ushtarake, që zëri i tyre të jetë më i fuqishëm. Ajo argumentoi se këto masa do ta përmirësojnë dhe ngrënë në një nivel më të lartë rolin dhe përgjegjësinë femrës ushtarake në Forcat e Armatosura. Në këtë panel diskutuan edhe Gjeneralmajor Irfete Spahiu, Atashe Ushtarak britanik nënkolonel Timothy Eight-Boycot, etj.

Në Panelin e Dytë “Sfidat dhe sukseset e të qenit grua në forcat e rendit” diskutuan Kolonel Florie Haxhaja, Kristina Jozic, Luljeta Ismalukaj, Vjosana Neziri, etj Konferenca u zhvillua në formën e pyetje përgjigje, por duke bërë edhe një hyrje rreth karrierës ushtarake apo civile të secilës pjesëmarrëse. Secila diskutante në panel, por edhe në pyetjet e komentet e bëra, ndanë me auditorin eksperiencën e tyre personale si femra në uniformë, por edhe punën e bërë nga institucionet dhe vendet që përfaqësonin. Ajo që binte në sy ishte se, disa nga vendet e rajonit, kanë krijuar shoqatat “Për mbrojtjen e femrave në uniformë nga diskriminimi dhe ngacmimet e ndryshme”. Këto shoqata funksionojnë në mënyrë vullnetare pa kosto financiare dhe drejtohen nga femra me gradë të lartë ushtarake. Një eksperiencë e tillë mund të aplikohet edhe në Forcat e Armatosura nëse nuk ka pengesë ligjore.

Në këtë aktivitet dyditor merrnin pjesë rreth 250 gra dhe vajza nën uniformë nga strukturat e Policisë së Shtetit, Doganave dhe Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe përfaqësues të niveleve të larta drejtuese nga vende të ndryshme të rajonit si: Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, të cilat ndanë eksperiencat e tyre personale dhe treguan rolin që ato kanë patur në fuqizimin e rolit të gruas në institucionet e tyre.

***Mjeshtër i Madh**



HISTORIA

Më 28 dhjetor 1943, me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm formohet një nga njësitë më të mëdha e të organizuara të luftës partizane

80 vjet nga krijimi i Brigadës IV Sulmuese

Brigada IV S i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet tyre N/komandant i Brigadës Pano Xhamballi, Xhafer Cenko Lubonja, komandanti trim Riza Taçi etj; të cilët prehen të qetë në altarin e lirisë së atdheut. Vetëm në luftën për çlirimin e Tiranës ranë në fushën e nderit 98 partizanë. Brigada IV S në 321 ditë të jetës së saj ka përshkruar 2200 km rrugë (në këmbë, jo me makina) duke kryer 265 luftime e operacione dhe duke i shkaktuar armikut mbi 2000 të vrarë e 200 robër (shumë ushtarë gjermanë) si dhe dëme të mëdha materiale e armatime



Më 28 dhjetor mbushen 80 vjet nga dita kur në Voskopojë u krijua Brigada e IV-t Sulmuese. Ajo ishte ndër njësitë më të organizuara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila në 321 ditë të jetës së saj ka përshkruar 2200 km rrugë (në këmbë, jo me makina) duke kryer 265 luftime e operacione dhe duke i shkaktuar armikut mbi 2000 të vrarë e 200 robër (shumë ushtarë gjermanë) si dhe dëme të mëdha materiale e armatime.

HISTORIA

Në qarkun e Korçës deri në dhjetor 1942 ishin formuar 18 çeta partizane, midis të cilave ajo e Mokrës (Pogradec), e Gorë-Oparit etj. Ndërsa nga tetori '42 deri në maj 1943 numri i çetave partizane u rrit akoma. Më vonë, me rritjen e numrit të forcave të kryengritjes së armatosur nga çetat u krijuan batalionet partizane si Batalioni i Mokrës, Gorës, Kolonjës, Rrëzes, Malit të Thatë, Batalioni "Shqiponja" etj. Si rezultat i luftimeve të ashpra të këtyre batalioneve me forcat armike u realizua çlirimi i zonës malore të Qarkut të Korçës.

Në gusht 1943 formohet njësi më e madhe luftarake e Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Makrezë të Vithkuqit me partizane e partizanë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, me komandant Mehmet Shehun, komisar Tuk Jakovën dhe zv/komandant Tahir Kadarenë. Ndërsa, më 28 dhjetor 1943, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm formohet Brigada e IV-të Sulmuese. Në përbërje të saj ishin batalionet me përvojë luftarake, si "Hakmarrja", "Reshit Çollaku", "Shqiponja", "Fuat Babani", batalioni Gorë-Opar si dhe "Rinia antifashiste dhe punëtorë" nga qyteti i Korçës. Në fillim Brigada kishte 550 partizanë e kuadro të organizuar në katër batalione: batalioni 1 me komandant Zija Kambo, i 2-të me komandant Petrit Dumen, i 3-të me komandant Spiro Moisiu e komisar Vaskë Gjinon, i 4-ti me komisar Andrea Ziu. Intendent i Brigadës ishte Raqi Qirinxhi. Brigada IV Sulmuese, një repart i armatosur, me 265 luftime dhe operacionet e saj u konfirmua si një njësi luftarake e aftë për të kryer detyra akoma më të mëdha. Ajo u rreshtua në Divizionin e I-rë Sulmues, të cilit iu ngarkua një detyrë e rëndësishme, siç ishte kalimi në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut dhe çlirimi i tyre nga okupatori nazist e kolaboracionistët e tij. Faqe lavdie e trimërie tregoi Brigada e IV-të S në Operacionin armik të Dimrit 1943-1944. Ajo zhvilloi luftime të përgjakshme dhe shpërtheu rrethimin që nazistët gjermanë kishin përgatitur gjatë këtij operacioni. Luftimet u kryen në kompaktësi bashkëveprimi mes batalioneve të brigadës. Në një kohë që forcat armike mendonin të shkatërronin forcat partizane të saj dhe forcat e Beratit, Brigada e IV-të S, e drejtuar nga shtabi i saj me në krye komandant Nexhip Vinçani e komisar Pëllumb Dishnica çau rrethimin në Qafën e Becit, duke kaluar në zonën e Beratit

Mbas çarjes së rrethimit, brigada u kompaktësua

dhe për një muaj rresht, me luftime sulmuese dhe në bashkëveprim me batalionet "Hakmarrja", "Shqiponja", "Reshit Çollaku", "Fuat Babani" e forcat sulmuese të fshatrave të qarkut çliroi shumë fshatra, duke filluar nga Arrëzi (Devoll), Malësia e Kolonjës, Vithkuqit, Gorë-Oparit, Shënepremte. Në pranverë, gjatë mësymjes pranverore, në bashkëpunim me batalionet "Reshit Çollaku" dhe dy batalione të Brigadës së I-rë S çliruan Pogradecin dhe Rrëzën e tij, Starovë, Tushemisht, Hudënisht, Piskupat, Grabovë. Mbas gjithë këtyre sukseseve, Brigada mbledhet në Lozhan për të bërë bilancin e luftimeve në 9 maj 1944. Numri i partizanëve ishte shtuar. Gjatë muajit maj brigada çliroi fshatrat në fushën e Korçës, Rrëzës, Gor-Opar duke përfshirë dhe zonën e Mokrës, Pogradecit, Malit të Thatë, Pojan etj.

Gjatë Operacionit Armik të Qershorit 1944, batalionet e Brigadës IV S zhvilluan luftime të ash-



pra në Qafë Thanë me forcat e Divizionit malor gjerman. Luftime të ashpra u zhvilluan në Maliq, Grabovë, Plloçë, Guri i Kamjes, Krosnisht, Moçan, Osojë, Gjinikas, Malin e Dusharit, Qafa e Gjarpërit, në Bitinckë e Bilisht.

KALIMI NË MËSYMJEN E PËRGJITHSHME

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇI lëshoi Urdhërin, më 28 Maj 1944 për kalimin në Mësymjen e Përgjithshme. Brigada IV S, pasi kishte kaluar një rrugë të suksesshme luftarake dhe në çlirimin e një territori të madh në Qarkun e Korçës, u inkuadrua

në Divizionin I Sulmues të UANÇI. Gjatë luftimeve në përbërje të këtij divizioni (brigada IV dhe V) çliroi Qarrishtën, Zërqanin, Matin, Homesh-Sofraçan, Fushë Alie, Grevë, Melan, në kazernat e Dibrës, kundër forcave gjermane e kolaboracioniste në Mirditë; çliroi Peshkopinë etj. Në dy javët e fundit të shtatorit Brigada e IV-të S zhvilloi luftime brenda në Elbasan dhe organizoi disa prita në rrugën Librazhd-Elbasan-Qafë Kërrabë.

Nga krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut populli u bind për luftën e drejtë kundër okupatorit dhe veglave të tij; u rreshtuan në radhët e partizanëve deri 2000 veta. Midis tyre kishte dhe disa partizanë italianë dhe armenë, të cilët kishin hyrë në UANÇI mbas kapitullimit të Italisë në shtator 1943.

Brigada e IV S shkroi faqe faqe lavdie gjatë operacionit për çlirimin e Tiranës. Ajo, së bashku me Brigadën e I-rë S, Brigadën e VIII-të dhe Brigadën e XVII-të sulmoi në një rajon tepër të fortifikuar; duke filluar nga kodrat pranë Kombinatit Tekstil në veriperëndim të Tiranës, deri tek kodra e Kopilit (sot sanatoriumi- varret e dëshmorëve të kombit).

Po ashtu mori pjesë në luftimet tek varrezat e dëshmorëve të kombit, në Pallatin e Brigadave, tek ish Kisha e Shën Prokopit (në veri të Liqenit Artificial, ish-kazernat e Shkumbinit (qyteti i nxënësve, brenda në qytet tek pallatet e Moskatit dhe të Shallvares dhe deri tek Banka).

Brigada IV S, në betejën historike të Mushqetas (duke filluar nga Qafë Kërraba-Mushqeta) luajti një rol të rëndësishëm në shpartallimin dhe asgjësimin e forcave të mëdha gjermane. Brigada e IV-të S në operacionet për çlirimin e Tiranës tregoi vlerat e saj si njësi luftarake e suksesshme dhe e denjë për emrin që mbante, duke përbushur me nder detyrat e ngarkuara. Aftësitë e kuadrove, partizanëve e partizaneve spikatën si çlirimtarë të suksesshëm. Rrugat luftarake e Brigadës IV S, trimëria, heroizmi i luftëtarëve të saj në luftë për çlirimin e vendit, janë sot një burim i madh frymëzimi për popullin dhe veçanërisht për brezin e ri.

Brigada IV S i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet tyre N/komandant i Brigadës Pano Xhamballi, Xhafer Cenko Lubonja, komandanti trim Riza Taçi etj; të cilët prehen të qetë në altarin e lirisë së atdheut. Vetëm në luftën për çlirimin e Tiranës ranë në fushën e nderit 98 partizanë.

(Sipas kujtimeve të Ing. Myfit Guxhollit, Ish-partizan i Brig. IV S dhe kryetar i OBVL)



KUVENDI

NË PRIZREN U MBAJT KUVENDI I DYTË I DEGËS SË ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LANÇ



Çlirimi i Prizrenit në një datë kyçe të antifashizmit

Nga Bashkim Hisari

Më 17 nëntor, në ditën kur para 79 viteve djemtë e vajzat partizane kurorëzuan luftën me fitore dhe çliruan qytetin nga pushtuesit nazifashistë u mbajt Kuvendi i Dytë i rregullt i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, dega në Prizren dhe u përkujtua 80 vjetori i Konferencës së Bujanit. Pjesëmarrësëve në Kuvend, pasardhësëve të veteranëve dhe dëshmorëve të LANÇ, familjarëve të delegatëve në Konferencën e Bujanit, antarëve të Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe atyre të degëve të kësaj organizate në Gjakovë e Prizren ju prezentua

raporti mbi punën 4 vjeçare dhe programi i detyrave të ardhshme të kësaj dege.

“Dita e çlirimit të Prizrenit, është një nga datat kyçe të antifashizmit që lidhet me pjesëmarrjen e shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore dhe me kontributin e tyre në mposhtjen e keqës më të madhe të shekullit 20-të. Konferenca e Bujanit që u organizua me iniciativën e Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Rrafshit të Dugagjinit ishte ngjarje më e rëndësishme në historinë e re të shqiptarëve ku u vënë themelet e shtetësisë së Kosovës, si subjekt konstitutiv i shtet i lirë dhe i pavarur” – ishin mesazhet kryesore në këtë Kuvend. Me interes u ndoq fjala e mbajtur nga kryetarja e organizatës së veteranëve të LANÇ-dega në Prizren,

Vjosa Curri-Simiçi. Ndër të tjera ajo tha se në periudhën 4 vjeçare dega e organizatës së veteranëve në Prizren ka mbajtur 23 takime. Antarët e organizatës aktivitetet e tyre i kanë përqëndruar në mbrojtjen e vlerave historike të popullit tonë, në promovimin e ngjarjeve dhe datave historike nga LANÇ dhe kanë përkujtuar heronjtë, dëshmorët dhe të gjithë ata që kanë kontribuar për lirin dhe pavarësin e kombit tonë. Kuvendi vlersoi lart bashkëpunimin në realizimin filmit dokumentar: “Fadil Hoxha-arkitekt i Kosovës së lirë”.

Punimet e Kuvendit përshëndeti kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Lekë Hoxha i cili përcolli urime të përzemërta dhe mirënjohje të thellë për sakrificat, kurajon dhe kontributin e partizanëve trima nga Prizreni dhe Kosova për liri dhe pavarësi.

Kuvendi zgjodhi Kryesinë e degës prej 7 antarëve, kryetare Vjosa Curri-Simitçi, nënkryetar Murat Qerreti dhe sekretare Vera Murati.

Për kontributin e dhënë në afirmimin e vlerave të LANÇ, në Kuvend u nda mirënjohje veteranit të LANÇ nga Prishtina Xhafer Haxhijakupit dhe veteranit të arsimit, antarit të Kryesisë së organizatës së veteranëve në Gjakovë Prof. Xhevat Koshit.

GJAKOVË – Përkujtohen dita e çlirimit dhe Formimi i Brigadës VII Sulmuese kosovare

Nga Afrim Deva

Në Gjakovë më 9 nëntor u shënuan dy data të rëndësishme të LANÇ: 79 vjetori i çlirimit të qytetit me rrethinë nga okupatori nazifashist dhe 11 nëntori i vitit 1944, dita kur u formua Brigada e VII-të sulmuese kosovare, domicil i së cilës ishte Gjakova.

Për të kujtuar këto vlera të shënuara, pasardhësit e veteranëve të Gjakovës sikur shumica e popullit shqiptar, vazhduan traditën e respektimit të luftërave çlirimtare të popullit, zhvilluan kulturën e kujtesës për ruajtjen e identitetit të kombit tonë, organizuan aktivitete të ndryshme dhe konfirmuan vendosmërinë historike për të vazhduar rrugën për drejtësi, liri dhe pavarësi të plotë. Në këtë ditë historike, veteranët dhe pasardhësit e tyre nga Gjakova, Prishtina, Prizreni, Peja dhe Vitija vendosën kurora në bustat e heronjve të pupullit Asim Vokshi, Emin Duraku, Hajdar Dushi, Sadik Stavileci, Mustafa Bakija dhe në Qendrën Memoriale të LANÇ “Fadil Hoxha” në Çabrat. Kurora u vendosën edhe në varrezat e heronjëve dhe dëshmorëve të UÇK-së.

Në tubimin kryesor që u organizua në varrezat e qytetit pranë varrit të themeluesit të njësisë partizane, komandantit, politikanit largëpamës dhe burrështetasit Fadil Hoxha i cili me punën, përkushtimin dhe veprën e tij i viri vulën një periudhe historike, pjesëmarrësit bënë homazhe dhe përkujtuan ngjarje të rëndësishme me ç’rast theksuan kontributin e luftëtarëve të lirisë për çlirimin e Gjakovës dhe Kosovës nga pushtuesit.

Luftimet për çlirimin e Gjakovës, filluan nga muaji tetor dhe zgjatën deri më 9 nëntor të vitit 1944, me ç’rast u çlirua qyteti. Gjakovën e çliroi



Brigada e V-të shqiptare dhe e IV-ta kosovare Në çlirimin e Gjakovës, kontribuan shumë edhe partizanët nga Malësia e Gjakovës bashkë me popullatën patriotike të Gjakovës që morën pjesë në luftën kundër gjermanëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Menjëherë pas çlirimit, më 10 nëntor në Gjakovë u mbajt një tubim i madh popullor, në të cilin morën pjesë të gjithë gjakovarët, duke pritur me gëzim dhe brohoritje partizanët dhe udhëheqësit e tyre. Në Ditën e çlirimit të Gjakovës,

pasardhësit e veteranëve të Gjakovës sikur shumica e popullit shqiptar, vazhduan të respektojnë traditën e luftërave çlirimtare të popullit.

Në tubimin kryesor në varrezat e qytetit të Gjakovës pranë varrit të heroit të popullit Fadil Hoxha dhe të ish kryetares së Organizatës së Veteranëve të Kosovës Vahide Hoxha, për luftën ngadhënjimtare antifashiste Nacionalçlirimtare foli nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës Bashkim Hisari.

DITËLINDJA

Kryesia e OBVL u ron anëtarin e saj në ditëlindjen e tij të 88-të

Shuaip Methasani, veterani që rrezaton mirësi dhe vlera

Halil RAMA

Më 27 nëntor 2023 veterani Shuaip Methasani, anëtar i Kryesisë së OBVL festoi 88 vjetorin e lidjes, i rrethuar nga familjarë, miq e shokë që e duan dhe i do aq shumë. Në shoqëri të tij të shumtë në Tiranë dhe pothuajse në të gjitha rrethet e vendit, si dhe në Prishtinë, ai njihet si intelektual që mishëron virtytet më të mira njerëzore: zgjuarsinë, mençurinë, fisnikërinë, dashurinë njerëzore, sinqeritetin, drejtësinë, solidaritetin, moralin e lartë dhe shpirtin human si fundamente kyçe të shoqërisë sonë. Dhe të gjitha këto virtyte ai i përçon më së miri edhe në dy librat e tij: "Sohodolli i Dibrës" dhe "Kujtime në vite". Dy libra – testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja e tij, Sohodolli, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë, traditat më të mira të këtij fshati e të krejt Dibrës. Janë padyshim dhurata më e çmuar për njerëzit e familjes, farefisin, të afërmit, shokët e miqtë e tij të shumtë në gjithë Shqipërinë dhe hapësirën mbarëshqiptare në botë. Njeriu i mirë dhe i veprave të mira Shuaip Methasani gjatë gjithë jetës së tij ka rrezatuar dhe përçuar mirësi, por dhe vlera në dobi të shoqërisë.

TAVOLINA E DIBRANËVE

Tek libri "Kujtime në vite", një mesitull interesant (faqe 62) është "Tavolina e dibranëve". Intelektuali që ka shërbyer me devotshmëri e përkushtim qytetar për afro dy dekada, pothuajse në të gjitha krahinat e fshatrat e Dibrës, edhe këtu në metropolin shqiptar, ku është vendosur familjarisht prej shumë vitesh, punon pa rreshtur për të lartësuar emrin dhe dinjitetin e dibranëve. Nëse në Tiranë njihen nga shumëkush "Rruga e Dibrës", "Lagja e dibranëve", (e krijuar e shumëfishuar përgjatë një shekulli që nga eksodi i tyre i 1913, e sidomos pas viteve '90), apo dhe Xhamia "Dine Hoxha" në rrugën e Kavajës (e ndërtuar me kontributin financiar të filozofit popullor të mirënjohur si një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog I), "Tavolina e dibranëve" në një lokal kafeneje në qendër të Kombinatit, është një tjetër vlerë e shtuar e këtij komuniteti, e ideuar dhe promovuar më së miri nga intelektual i mirënjohur Shuaip Methasani. Është kjo, tavolina ku ai nuk mungon thuhet asnjë ditë për t'u takuar e kuvenduar me miqtë e tij, jo vetëm dibranë, por edhe tepelenas, vlonjatë, shkodranë, nga Tirana dhe nga e gjithë Shqipëria. "Duke përdorur edhe alegorinë dibrane në muhabete e sipër e me kundërshtime ndaj njërit-tjetrit, ato të tavolinave tjera dhe njerëzit e shërbimit në lokal çuditën me ne. Një ditë i kishin thënë asaj kamarieres 2-3 veta nga Jugu e Tiranës: More, po ata dibranët që u zunë dje në muhabate, a prapë qenkan bashkë?! Nuk u merret vesh dibranëve, kur flasin përdorin shumë thumba...". Dhe në të vërtetë vetë Shuaipi është përçuesi më i mirë i alegorisë dibrane, të përçësuar në odat e kuvendet e Dibrës, por edhe nga kryevepra e Hazis Ndreut "Alegoria dibrane" si dhe nga "Kanuni" i shkrimtarit të shquar dibran Xhafer Martini. Libri ka qenë miku dhe bashkëudhëtar i mirë i Shuaipit në tetë dekadat e jetës së tij, ndaj mos u çudisni nëse nga një vizitë rastësore në shtëpinë "Methasani" në një lagje të Kombinatit në Tiranë, do të gjeni një bibliotekë aq të pasur, konkurrenë në tituj e rubrika me ato të institucioneve. Ndërsa në bibliotekat tona, dy librat e tij duhet të zënë vend nderi, pasi ua kushton prindërve (babait Sulejman dhe nënës Fie), motrave Hike e Servete që e kanë mbajtur në krah kur ishte i vogël, bashkëshortes Farie – një zonjë e nderuar e fisnike,

Pothuajse në të gjitha veprimtaritë promovuese të OBVL në Tiranë, të pesëmbëdhjetë viteve të fundit, ka spikatur me prezencën dhe performancën e tij edhe veterani Shuaip Methasani



fëmijëve të mrekullueshëm: Defrimit (moderator i shkëlqyer i dhjetra veprimtarive promovuese e argëtuese dhe ndër më të mirët e gazetarisë sportive në rang kombëtar), Artanit, Natashës, Nderimes e Lilianës që e kanë nderuar si me shkollimin dhe me punët që kanë punuar e punojnë, dy nuseve të djemve, Lume e Naze, nipave e mbesave që e lumturojnë pafund, miqve dhe shokëve të tij të mrekullueshëm... Një përkushtim brilant për ata që përbëjnë embrionin e familjes nga buron atdhedashuria e tij e flaktë. Dhe në çdo faqe të tyre gjejmë aspekte nga historia e lavdishme e popullit tonë, por dhe ngjarje e detaje jetësore befasuese.

JETA DHE VEPRIMTARIA E NJË INTELEKTUALI SHUMËDIMENSIONAL

Ka qenë fare i vogël, 6-7 vjeç, por e ka të ngulitur në kujtesë pushtimin fashist të vendit më 1939 dhe reagimin e tij prej fëmije të inatosur nga ky pushtim i egër. "Ishte prill 1939. E mbaj mend mirë kur erdhën italianët me makina e mushka të mëdha me artileri; kaluan lagjen tonë dhe dolën në vreshtat nën varre të Skëndere, vendosën çadrat e ushtrisë...ndërsa ne afroheshim ashtu si fëmijët që duan të shikojnë çdo gjë...". Më tej kujton thirrjen e tyre italisht atëhere: "ej pikoli, vjeni kua, vjeni kua..." ndërsa vetë Shuaipi e shokët e tij të fëmijërisë, Imeri, Pajaziti, Zaimi, Cena, Hakiu etj, u afroheshin italianëve, e ata nxirrnin mallin e njerëzve të tyre që kishin në familjet e veta....

Në vitin 1944 vijon mësimet në shkollën fillore të xhamia, me mësues Halil Shehun nga Vlesha e të tjerë që erdhën më vonë nga Vlora, Elbasani e Shkodra...Nxënësi i zellshëm Sh.Methasani më pas do të ngjiste shkallët e dijes e formimit arsimor e kulturor në

të gjitha nivelet: 7-vjeçare, pedagogjike e deri të lartën. Që nga 1944 e deri në mbarimin e shkollës së lartë ka kaluar me shumë shokë e shoqe, në klasa paralele e auditore të ndryshme. "Kështu, e fillova me Osman Hysen Pajazitin, Xhemën, Alushin, Cenën, Ismetin e Selimin dhe e mbarova me Nikollë Brozin nga Mirdita, Omer Hashorvën nga Gjirokastra, me Mentor Muçën, Rustem Devën, Vera Haxhiun, Liljana Mitin, Shpresa Barbulushin, Nikoll Kolën, Izet Durmishin, Hajdar Kastratin, Rustem Lleshin, Servet Pëlumbin, etj", shkruan Shuaipi në librin e tij "Kujtime në vite" (faqe 53). Janë vërtetë kujtime mallëngjyese por edhe mbresëlënëse jo vetëm për autorin, por edhe për lexuesin.

Të përshkruara mjeshtërisht si mbresa e kujtime nga jeta e puna e tij në zonën e Shupenzës e Gjoricës (1968-1971), në Zogje të Dibrës (1982-1984), në Kalanë e Dodës – ballkonin natyror të Dibrës e gjithë Shqipërisë ku punoi e jetoi për 12 vjet (1971-1982), në zonën e Çidhnës (1984-1989), në Sllovë, etj, formojnë profilin e këtij intelektual që kudo shërbeu me devotshmëri e përkushtim qytetar.

Vetëm një intelektual i mirëfilltë si Sh.Methasani, duke e konsideruar mirënjohjen si shprehjen më të bukur të karakterit të njeriut, në moshën e tretë merr penën dhe shkruan me realizëm e objektivitet për shokët e miqtë e tij të shumtë. Kështu ai në dy faqe të librit të tij me kujtime (12-13) rendit emrat e qindra intelektualëve dibranë me të cilët ka patur fatin të punojë. Dhe po me atë dashuri të pakufishme shkruan për "Dibrën e margaritarëve", Dibrën e 9 maleve, teqeve dhe oxhaqeve të përmendura...Ndërkohë si kontribut real në gjeopolitikë ai jep përkufizime të qarta për "Dibrën e shtrirë në një hapësirë

pa fund, si një vilajet i stërmadh, që nis nga Mati në njërin anë e nga Luma në tjetrën dhe duke pasur përbri e afër këtë Kukësin, Mirditën e Librazhdin, e matanë, Strugën e Ohrit dhe pas më larg Kërçovën, Tetovën etj, me një reliev të thyer, plot me male, kodra, ultësira, fusha e luginat...Ai përshkruan bukur e thjeshtë: Dibrën e Korabit gjigand e legjendar dhe disa male të tjera që i qëndrojnë krahinës si një kurorë e bukur mbi kokë, duke ia shtuar edhe më shumë madhështinë e krenarinë; Dibrën e Drinit të Zi që gjarpëron mijëra metra tejmbanë Veriut dhe pasi bashkohet me Drinin e Bardhë arrin në Shkodër tok me Bunën e derdhen në Adriatik; Dibrën e shtatë liqejeve margaritarë e piktoreskë të Lurës; Dibrën e shumë pasurive të mëdha natyrore, kromit, gipsit, sulfurit e lixhave ku kurohen me mijëra njerëz; Dibrën e traditave në bujqësi e blegtori, të frutikulturës, sixhadeve e qlymave të Kalasë së Dodës; Dibrën e sofrës, pushkës e penës, urtësisë dhe mençurisë; Dibrën e arsimit, kulturës, sportit, besës e flamurit; të fiseve e familjeve të mëdha e emrave që kanë shkruar e bërë histori, si: Gjergj Kastrioti, Iljaz Pasha, Elez Isufi, Nikollë Kaçorri, Vehbi Dibra(Agolli), Dine Hoxha etj; Dibrën e shumë heronjve, mësuesve e pedagogëve, inxhinierëve, mjekëve e mjeshtërve të artit, kulturës dhe sportit, si: Haki Stërmilli, Haki Sharofi, Suljeman Pitarka, Drita e Esma Agolli, Muharrem Xhediku, Hazis Ndreu, Shaban Sinani, Agron Tufa, Bujar Kapexhiu, Gëzim Erëbara, Femi e Tasim Oshafi, Avni Resuli, Zenulla Hatibi, Xhemil Simixhiu, Agim Krajka, Hiqmet e Nexhat Agolli, Adivie e Yllka Sharofi, Edip e Engjëll Tërshana, Sadik Botku, Liri Rasha, Arif Vladi, Arben Spahiu etj.... Po ashtu e gjejmë Shuaipin përkrah të birit gazetar e moderator, Defrimit, tek promovon të mëdhenjtë e sportit, kampionët botëror Ismail, Gjetan e Ferit Keta, Bari Mehmeti (Meçollari), Erzen Rustemi, apo dhe artistin shqiptaro-amerikan me famë botërore Xhevat Limani.

Dhe si gjerdan në kurorën e lavdisë dibrane, ai nuk nguron të rendisë edhe miset shqiptare me origjinë dibrane Denisa Kola, Ilda Reka e Migena Ramadani.

Vetëm një studjues tejet i vëmendshëm e skrupuloz si Shuaip Mehtasani mundet të evidentojë kaq shumë emra të spikatur dibranësh në fusha të ndryshme, siç evidenton "odën e burrave", "traditën e fisit", objektet dalluese të vendlindjes së tij, "sohodollasit e Tiranës" apo "Familjet nga Sohodolli me banim në Tiranë". Parë në tërësinë e individualitetit të tij krijues, Shuaip Methasani është një enciklopedi e gjallë për Dibrën e dibranët.

CEREMONIA

I paharruar kujtimi dhe akti heroik i dëshmorit Dushan Shametaj! Lavdi dëshmorëve të Fekenit

Eshtrat e dëshmorit Dushan Shametaj, në varrezat “Dëshmorët e Kombit”

Që nga data 15.11.2023 eshtrat e dëshmorit të atdheut, Dushan Shametaj, do të prehen pranë varrezave “Dëshmorët e Kombit”, ku prehen edhe gjithë dëshmorët e atdheut, që dhanë jetën për çlirimin e vendit. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në emër edhe të Ministrit të Mbrojtjes zotit Niko Peleshi dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneralmajor Arben Kingji, ju përcolli familjarëve (bashkëshortes Donika, fëmijëve Doljan dhe Elvana, vëllezërve Balil, Moisi dhe Bedo) ngushëllimet më të thella dhe mirënjohjen për aktin sublim të dëshmorit të Atdheut Dushan Shametaj.

“Dyzetë e dy vite më parë, në dimrin e acartë, në malin e Meçekut, në një stërvitje dimërore të studentëve të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, më 6 shkurt 1981, në një ditë tragjedi, heroizmi dhe solidariteti ushtarak, dhanë jetën në lulen e rinisë 11 ushtarakë, midis tyre, komandanti i batalionit, Dushan Shametaj, shefi i planizimit Çlirim Pulaj, pedagogu i taktikës Nikollaq Bero dhe studentët: Aleko Gjoni, Besnik Shehu Bilbil Pashaj, Ilir Gramatikoi, Bujar Ago, Pëllumb Rrapo, Qemal Lika, Nexhip Çoba, të cilët me Vendim Nr. 2506/2 datë 01.09.1999 të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, u shpallën “Dëshmorë të Atdheut”,-tha ndër të tjera numri dy i FA të RSH gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Familjet e të rënëve, prindërit, bashkëshortet, fëmijët, ashtu si edhe familja e komandant Dushanit përjetuan momente tepër të vështira. Bashkëshortes, Donikës iu desh të përballonte me kurajo jetën me dy fëmijët e saj të mitur, Doljanin dhe Elvanën, por duke qenë krenar për sakrificën sublime të bashkëshortit dhe babait të tyre të paharruar komandant Dushanit.

Gjeneralmajor Shehu tha se “Komandanti i batalionit 31 vjeçari nga fashati Dorëz i Tepelenës, Dushan Fejzi Shameti, së bashku me oficerët Çlirim Pulaj e Nikollaq Bero dhe plot studentë të tjerë, edhe pse nuk ishin në momentin e rënies së ortekut të parë, shkuan në ndihmë të shokëve të tyre studentë dhe në përpjekje për të shpëtuar jetë, dhanë jetën e tyre nga orteku i dytë më i forti, më i tmerrshmi dhe më tragjiku.

Dashuria dhe solidariteti që ekziston midis ushtarakëve, i bëri ata të flijonin jetën. Për Dushanin me shokë nuk kishte qetësi, vendi nuk i mbante kur studentët e shokët e tyre përplaseshin me forcën e natyrës. Të tillë ishin edukuar e kalitur ata ushtarakë nga familjet dhe nga zona nga vinin, por edhe



nga edukata dhe arsimit i marrë në shkollën ushtarakë, ku dashuria dhe respekti për njëri tjetër arrijn shkallën më të lartë të ndërgjegjes së tyre.

Kanë kaluar vite e do të kalojnë edhe të tjerë, por 11 “Dëshmorët e Fekenit” do të mbeten të paharruar në memorien tonë si ushtarak, në kujtesën tuaj e të çdo familjari.

Emri i tyre sot është lartësuar në emra shkollash e rrugësh, skalitur në libra me poezi, proza e poema, në film dokumentar “Orteku”.

Një pllakë mermeri me emrat e tyre është vendosur në Fekenë, atje ku ata dhanë jetën. Në lulishten kryesore të Garnizonit Ushtarak “Skënderbej”, është ngritur Memoriali, ku është vendosur një copë shkëmb nga Mali i Meçekut dhe skalitur 11 emrat e tyre. Ndërsa ish studentit e bashkëmoshatarit i tyre, Agron Zerani, njëri nga të mbijetuarit e kësaj ngjarje, në kujtim të tyre më 6 shkurt të këtij viti, mbolli 11 selvi pranë liqenit të Farkës që simbolizojnë jetën e 11 dëshmorëve. Ata do të mbeten burim frymëzime për brezat e ardhshëm. Duke përfunduar zv/shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH gjeneralmajor Manushaqe Shehu tha se “Kujtimi i dëshmorit Dushan Shametaj do të ngelet i paharruar në kujtesën e familjarëve dhe të afërmëve dhe të gjithë ushtarakëve shqiptarë. Ai tani do të prehet akoma më i qetë përkrah dëshmorëve të tjerë të atdheut”.

Organizata e Dëshmorëve në Familjen e Afrim Bunjakut

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

“Të vdesësh për atdhe është sikur të rilindësh përsëri”, me këtë mision ditë më parë një grup i Kryesisë të Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ-it dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut bërë një vizitë ngushëllimi dhe mirënjohje për aktin heroik të Yllit të pashuar të Dardanisë, Afrim Bunjaku. Grupi i përbërë nga kryetari i Organizatës Dr. Gjergji Velo, si dhe nënkryetarët Spartak Braho, Shaqir Vukaj, Bernard Zotaj dhe anëtarit i kryesisë Xhavit Lashi u pritën nga Xhavit Jashari kryetari i Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve të Kosovës, i cili i shoqëroi për në familjen e heroit në fshatin Samadrexha të Vushtrrisë. Ata u pritën nga familjarë të heroit, bashkëshortja, djemtë dhe familjarë të tjerë të familjes Bunjaku.

Afrim Bunjaku ka lindur më 15 prill 1973. Pas përfundimit të studimeve ushtarake me pozicion rreshter, prej vitesh ka shërbyer në uniformat blu të Kosovës. Ai ishte babai i dy djemve dhe një vajze. Kryente detyrën në Zveçan pas dorëheqjes së bujshme të serbëve nga strukturat policore. Rreshter i Policisë së Kosovës Afrim Bunjaku u vra në orët e para të ditës së diel më 24 shtator 2023 nga një grup kriminelësh serbë të armatosur rëndë në Banjskë të Zveçanit. Persona të armatosur i kanë bllokuar rrugën makinës së policisë me dy kamionë në aksin Mitrovicë-Leposaviç. Më pas ata kanë qëlluar



ar në drejtim të makinës së policisë, ku për pasojë humbi jetën Bunjaku. Dr. Gjergji Velo ju shprehu ngushëllimet familjarëve për aktin heroik të birit të tyre Afrim Bunjaku dhe i dorëzoi djalit të tij Medaljen e Mirënjohjes nga Organizata e Dëshmorëve si motivacion: “Familjes Bunjaku që rriti dhe edukoi me tradita patriotike heroin shqiptar, i cili mbrojti integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës, dinjitetin e kombit tonë. Portreti dhe profili i Afrimit u skalit në kujtesën e Organizatës së Dëshmorëve, si fytyra e nje heroit dhe si vepra e një dëshmorit të Kombit Shqiptar. Akti heroik i Tij do të frymëzojë brezat si të mbrohet Atdheu. Familja Bunjaku dhe shoqëria shqiptare janë krenarë për heronj të tillë”.

Familjarët falënderuan Organizatën e Dëshmorëve për ngushëllimet, për mirënjohjen dhe vlerësimet për Hero-

in Afrim Bunjaku. Shprehën ngushëllime dhe vlerësuan lart aktin heroik të Heroit më të ri të Kosovës dhe të dëshmorit të Kombit edhe Spartak Braho, Shaqir Vukaj dhe Bernard Zotaj. Me familjarët u bë një foto për kujtim. Më pas të shoqëruar nga familjarë dhe përfaqësues të Familjeve të Dëshmorëve të zonës Vushtri, Samadrexhë, në nderim të Heroit Afrim Bunjaku, u vendosën buqeta me lule në varrin e Tij, si dhe u mbajt një minutë heshtje për të nderuar aktin heroik dhe gjakun e derdhur për mbrojtjen e kufirit të dëshmorit Afrim Bunjaku. Më tej bëme një vizitë në varrezat e dëshmorëve të Vushtri, Bletaj. Nga kjo vizitë ngushëlluese dhe mirënjohje morëm me vete morëm vizionin e njerëzve luftëtar që luftuan dhe derdhen gjakun për tokën e shtrenjtë të Kosovës dhe të Shqipërisë.

SUPLEMENTI LETRAT

CIKËL ME POEZI NGA Bashkim KOZELI

Poet, dramaturg, skenarist, Kolonel në pension

Letër Fan Nolit

Fort i dashuri Fan Nol,
I nderuari im zot,
Çpate që na shqipërove
Sançon dhe një Don Kishot ?

Se Sançua dhe Don Kishoti
Shqipërisë iu ngjitën ligisht,
Sapo Ti i shqipërove.
Ata s'flasin më spanjisht...

Të dy sa s'thëjnë ekranin
Në çdo ditë e në çdo orë...
Sançua pamje babaxhani,
Don Kishoti me tabor...

Me tabor e trima bese,
Ca të hurit, ca të thikës.
Para këtyre kreshnikëve,
Kot është Garda e Republikës !...

Lum ne, lum Shqipëria
Me këtë Sanço e Don Kishot !...
Çpate që na i shqipërove,
I nderuari im zot ?...

Nga cikli poetik për LANÇ

Dita e çlirimit

Atë mengjes unë, populli, u gdhiva i lirë
Dhe nisa jeten me tjetër kalendar..
Oh, ç'mall që kisha dhe dëshirë
Të perqafoja fort çdo çlirimtar !..
Ajo Dite gjithcka te kalbur e perpiu,
Ate dite u shfaq një hark i madh ylberi...
Pushuesit, tradhtarët i ndau nga ana e shiut,
Mua popullit fukara me dha anen e Diellit...

Dashuri partizane

Ata duheshin heshturazi ne mal,
Diten e Çlirimit e shpallen k'te dashuri..
Ai e shpuri vajzen në dyqan,
Por asaj s'i hynte ne zemer asnje stoli..
I peshperiti djalit dicka te veshi
Dhe ata nisen te qeshin e te qeshin...
Qeshnin dhe syte iu mbeten tek dyqani i bukes...
Endrra e pare e pas luftes !...

Një kujtim i Tendës së Qypit

Mes plumbash te harbuar, si vetetima rrebeshi
Ku trup me trup ne po perlesheshim...
Nje bajonete me cpoi gjer ne kocke.
Dhe une rashe pa fryme ne toke.
Nuk di qysh me shpetuan shoket...

Kur vajta ne pervjetorin e Betejes.
Fshatare te asaj ane fytyra u shkelqeu,
Doemos, me dinin te rene.
Por mua dicka tjetër me mallengjeu:
Nje djaloshi ata emrin tim i kishin vene...

Nga cikli kushtuar dëshmorëve të aviacionit

UDHEHEQESI I FLUTURIMEVE

- Pilotit Sali Dibra

Tek ai shkodran ne krye te fushes,
Marrin leje pilotet per fluturim.
Here i qete si rrjedha e Bunes,
Here i shqetesuar si lumi Drin.

Zeri i tij eshte prind e vella,
Zeri i tij iu shpeton koken...
I ngjit ne qiell la e me la,
I zbret te puthin token...

PILOTIT

DESHMOR KASO PETOSHATI

Rapsodi Dule eshte kenge i teri
Dhe iso i mban gjithe fshati
Nje dite mes kanges u ndje nje vaje..
Qe mbesa e Kaso Petoshatit.
Te gjithe e nderpene ison
E Dulja heshti hijerende.
"Mos qaj, i tha vazes se vogel,
Per Kason do te ngre nje kenge .."
Dhe nisi kengen rapsodi Dule ,
Sa u drodh gryka e Dukatit.
A thua shkonte mbi vendlindje
Avioni i Kaso Petoshatit...

PILOTIT FLAMUR MICKO

- Komandantit te skuadriljes per studentet fillestare

A te kujtohet o femini e halleve
Cobani i dhive i mitur, i paditur,
Qe i kulloste cukave e stralleva
Me barkun bosh e zemren e cflilitur ?
Sot fluturon si shqipe siper maleve...

A te kujtohet, o kohe e partizaneve
Ai djalosh i vogel me mes radheve,
M'i shkurter si pushka qe kish kraheve ?...
Sot zogjite e shqipes ai i ben me flater,
Qe te mesohen me qiellin e kalter...

T'U FIK AVIONI, HEJ BILAL !

- Pilotit Bilal Sina

Ku shkon ashtu ti permby mal,
Qysh fluturon i qete ?!..
T'u fik avioni, hej Bilal,
T'u fik, po shpeto jeten !!..
Motori hesht, ne kufje heshtje.
Treguesit s'levizin, heshtin...
Nga poshte Atdheu sheh me rreqethje,
Me ankth shoket te presin...
Jeta te numeron minutat,
Ti s'i ndahesh avionit...
C'magji i bere qe erdhet bashke
Ne pisten e aerodromit ?!..
Mos valle perles kraheargjende
Motor i vure zemren tende ?!..

KUR ME NDALUAN TE FLUTUROJ...

- Per shkak te demtimit me parachute

Veshtroja detin ne vetmi..
Nga bregu hidhja therrime
E prisja me syte ne kaltersi
C'mysafir deti do te afrohej ne sofren time.

..
Por , sa rane therrimet ne cipen e detit
U turr pulebardha me majen e sqepit
Dhe me klithmen e saj "Krau ! krau!"
Me shau

" Pse rri si qyq? Cfare te ka gjetur?...
Ti mik ke mua, jo peshqit e fjetur !.."
Keshthu me tha e lartesine cau,
Krau ! Krau !....

Me rastin e datlindjes

PIRRO MANIT

Veshtire e kam te bej portretin Tend,
Por edhe Ti s'e pate aq te lehte,
Qe ne nje skene dy pellmbe vend,
Te ringjallje aq jete...



Ti na u shfaqe tek "Pamje nga ura"
Me ze rrufeje si Zeus.
Ne dramen moderne amerikane
Dhe realizmin klasik rus.

Por s'ish Rusia, as Amerika,
Qe i dha prush atij sukcesi,
Ish geni Yt, shpirti shqiptar
Me dimensione universi...

Dhe thame ne: "Kush eshte ky mjeshter?!"
Dikush u gjeji. "Ngjan nga i ati,
Babai ngriti ura jete,
I biri po ngre ura arti..."

Dhe nise Ti k'te veper arti,
Qe quhet Regjisure,
Naimin, Xhepen, Kadrine, Sulen...
Kollona i vure ne k'te Ure...

Keshthu i dhe Ti Artit Shqiptar
Nje Ure te Madhe me shume harqe...
Dhe nga cdo hark ne shihnim boten,
Sic shihnim veten ne cdo shfaqje...

U bëra ëndrra jote baba

Vajzës së shokut tim, sopranes së famshme
Ermonela Jahos -

Unë ndjehem në të shtatin qiell,
Kur operat këndoj në skenë,
Kur mbushen sallat në Bruksel,
Në Romë, Londër, Paris e Vienë..
Në Romë, Paris e Vienë..

Më këndon shpirti, harroj çdo famë...
I lutem Zotit çka më dha !...
Po kur shoh veten në reklamë,
Më shfaqesh Ti, baba...
Më shfaqesh Ti, baba..

Sa herë mbështillem dimrit te ftohtë
Këtej, larg Mëmëdheut,
Unë kujtoj shallin tënd të ngrohtë
Kur dilja prej Liceut...
Kur dilja prej Liceut...

Hallet e jetës së vështirë
I mbajtën , oh!, supet e tua...
Se kishe ëndërr dhe dëshirë
T'me jepje flatra mua...

Pas shfaqjes - brohori dhe lule
Mes emocioneve të mëdha...
E unë me nderim përkulem
Edhe për Ty, baba...
Edhe për Ty, baba !...

Oh, ç'mall për Ty, o ati im ,
Në skenat e kësaj bote !...
Lotët m'i mban i vetmi ngushëllim:
U bëra ëndrra jote...
U bëra ëndrra jote !...

SUPLEMENTI LETRAT

Shënime për librin e 24-t të tij “Të fitosh titullin njeri”

Njeriu i mirë, njeriu i ditës në qendër të publicistikës letrare të Halil Ramës

• Në këtë libër Halil Rama shkruan për Gjeneral Rrahman Parllakun, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, për majorin e rënë në krye të detyrës në misionet e NATO-s, Klodian Basri Tanushi, për dëshmorin dhe luftëtarin e dy luftërave botërore Ahmet Feta Camin etj. Po kështu autori shkruan për Dr. Sali Kurtin, për Prof.dr. Ali Tonuzin, Dr. Fatos Hoxhën, mjekë të shquar dhe njerëz të mirë që rrezatojnë paqe e mirësi.

• Jo rastësisht ai e nis kapitullin e parë me ambasadorët e paqes të nderuar rishtaz, me gruan e parë shqiptare me gradën Gjenerale Majore në Forcat e Armatosura të Shqipërisë që kryen për dy mandate detyrën e rëndësishme të Zv Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Një ushtarake model, por edhe një grua e nënë model

Sakip CAMI – Shkrimtar&publicist

Që në fillim të librit flet titulli: “Të fitosh titullin njeri”, që do të thotë se mund të jesh edhe lider, politikan, profesor e doktor, por që të meritosh titullin njeri duhet të luftosh që ta fitosh atë se jo çdokush është njeri i mirë me plot kuptimin e fjalës njeri i mirë, aq më tepër në kohën që kalojmë ku krimi, korrupsioni, vjedhja dhe vrasja janë fjalë që dominojnë në fjalorin tonë të ditës.

Autori Halil Rama, Mjeshtër i Madh, me një përvojë 45 vjeçare në publicistikë, vjen me librin e tij të 24-t sikurse edhe në librat e tij të mëparshëm, pas qëmtimit dhe përzgjedhjes që u bën personazheve pozitivë të ditës në Shqipëri, Kosovë dhe në të gjitha trevat shqiptare.

Jo rastësisht ai e nis kapitullin e parë me ambasadorët e paqes të nderuar rishtaz, me gruan e parë shqiptare me gradën Gjenerale Majore në Forcat e Armatosura të Shqipërisë që kryen për dy mandate detyrën e rëndësishme të Zv Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Një ushtarake model, por edhe një grua e nënë model.

Po kështu autori shkruan për Dr. Sali Kurtin, për Prof.dr. Ali Tonuzin, Dr. Fatos Hoxhën, mjekë të shquar dhe njerëz të mirë që rrezatojnë paqe e mirësi.

Por autori shkruan edhe për 80 vjeçarën Muharrem Gjoka, Mjeshtër i Madh, presidentin e Ansambli “Hazis Ndreu”, që së bashku me një mjeshtër tjetër, Avni Ndreun, të birin e Hazis Ndreut, Nderi i Kombit, kanë ngritur dhe drejtuar një ansambël folklorik me këngë dhe valle popullore ku bëjnë pjesë fëmijë, të rinj e të reja, gra dhe burra të të gjitha moshave, një ansambël që ka dhënë koncerte e ka konkuruar në të gjitha trevat shqiptare.

Autori Halil Rama lëvron edhe publicistikën historike. Ai drejton edhe gazetën “Veterani”, ku pasqyrohen edhe veprimtaritë e Organizatës së Veteranëve e pasardhësve të LANÇ të Kosovës.

Në këtë libër ai shkruan për Gjeneral Rrahman Parllakun, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, për majorin e rënë në krye të detyrës në misionet e NATO-s, Klodian Basri Tanushi, për dëshmorin dhe luftëtarin e dy luftërave botërore Ahmet Feta Camin etj.

Përveç publicistikës Halili ka shkruar me sukses edhe shumë kritika letrare, duke plotësuar kështu edhe një boshllëk të mungesës së këtij institucioni letrar.

Në këtë libër, por edhe në ato të mëparshmit, Halili ka shkruar dhe evidentuar vlerat artistike të shumë shkrimtarëve dhe poetëve shqiptarë ku mund të përmendim veprën e plotë letrare të Shefki Karadakut, romanet “Anja” dhe “Brega e Prokurorit” të Ahmet Prençit, romanet e Zija Çelës, Besnik Mustafajt, Bashkim Hoxhës, Namik Dokles, Preç Zogaj etj.



Në këtë libër ai ndalet te poezia e Alban Balës, te romani “Covid 1984” të Namik Dokles, te romani i fundit i Ahmet Prençit si dhe te romani “Hirushja pellazge” të Astrit Gjunkshit.

Si qytetar i ndërgjegjshëm dhe i shqetësuar për temën e ditës, autori ndalet te libri i Prof.Ass. Ardit Bidos që analizon tendencat e disa minoriteteve për të zmadhuar shifrat e Censurit dhe për të arritur me mashtrime e presione 20 përqindshin e popullsisë që do ta kthente Shqipërinë në një shtet multi-etnik, në një kohë që shqiptarët janë banorë të 6 shteteve të Gadishullit Ilirik.

Mjaft interesante historia e Harun Domit, mësuesit nga Radomira që e solli abetaren e Naum Veqilharxhit nga Stambolli për nxënësit e tij. Dhe jo rastësisht nga familja Domi kanë dalë dekadë pas dekadë intelektualë të shquar që i kanë shërbyer vendit.

Në promovimin e poemës voluminoze “Zani i Dibërs” të Hysen Dervishit, H.Rama nënvizon përpjekjen e H. Dervishit për t'i bashkuar figurat historike përrreth kombit, pikërisht atë që nuk po e bën dot politika që nga viti 1912.

Autori Halil Rama është tepër i ndjeshëm për intelektualët, muzikantët dhe sportistët shqiptarë që militojnë jashtë Shqipërisë, por që me veprën e tyre janë kthyer në ambasadorë të çështjes shqiptare në botë. Në librin e 24-t të tij ai shkruan për pianistin e shquar Justin Gjata dhe koncertin e tij

në Tiranë.

Halili bie në sy për përkrahjen dhe pasqyrimin e librave të poetëve dhe shkrimtarëve të rinj kudo qofshin ata, i ndërgjegjshëm se këta krijues nuk kanë arritur përsosmërinë, por askush nuk është i përsosur.

Në hullinë e studimeve historike autori Rama vlerëson punën dhe veprën e studiuesit Fatos Daci për origjinën dibrane të Skënderbeut mbi bazën edhe të literaturës dhe kinematografisë turke.

Edhe në Dibër të Madhe, ku është zemra e dibranëve, Halili së bashku me moderatorin dhe gazetarin e mirënjohur Dëfrim Methasani është i gjendur për pasqyrimin e veprimtarive kulturore dhe atdhetare të komunës së Dibërs në RMV.

Duke analizuar dokumentarin e Ylli Pepos për minierën dhe qytetin e Bulqizës, Halili futet në minierën e kujtesës dhe krijimtarisë së tij ndër vite për këtë qytet, në reportazhet e fotoreportazhet e gazetës “Bulqiza” që ai drejton që nga viti 1992 dhe na jep një panoramë të detajuar për këtë qytet dhe për këta minatorë heronj, shumicën e të cilëve i njeh nga afër.

Publicistika e Halil Rama nuk është e stisur, por kaq njerëzore sa që i ngjan copëzave të përditëshme të realitetit, për pasqyrimin e të cilave kemi kaq shumë nevojë të gjithë si komb dhe që Halili e bën me mjeshtëri, pasion dhe dashuri.

145 VJETORI I RËNIES

HITO ZENEL HITAJ, KAPEDANI I LABËRISË QË NUK E TREMBI EKZEKUTIMI

• *Hito Zenel Hitaj, prijësi dhe kapedani i Labërisë dhe luftëtari trim (1830-1878), që u vra nga pushtuesit osmanë më 12 të vjeshtës së dytë të vitit të LSHP-së, (më 12 tetor 1878) në moshën 48 vjeçare në fshatin Vajzë të Vlorës, por që ngeli përjetësisht në këngët e popullit.*

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Përkujtimi i luftëtarëve të Labërisë, që kanë rënë në lufrat e popullit shqiptar për liri, pavarësi dhe tërësinë territoriale të truallit arbëror, si dhe për ruajtjen e identitetit dhe të vlerave të Labërisë dhe mbarë shqiptarizmit është detyrim brezash. Hito Hitaj është një figurë e shquar e Labërisë, prijës e luftëtar i sprovuar betejave, që nami i ka shkruar deri në "dovlet" në qendër të sulltanatit në Stamboll. Kundërshtimi me armë i pushtuesve ka qenë një praktikë për shqiptarët në shekuj, që kurrë nuk e pranuan pushtimin. Labëria që pas epokës së Motit të Madh të Gjergj Kastriotit Skënderbeut zhvilloi kryengritje të përgjakshme sidomos në vitet 1472-1492, vit kur fituan të drejtën e vetqeverisjes me "venome". Labëria dhe e gjithë hapësira shqiptare ishte dhe ngeli vatra e zjarrit të ndezur kundër çdo pushtuesi prandaj edhe këndohet: "Labëri, o mal me thika, djemtë e tu trima me çika", apo dhe më tej "Kurvelesh, o gur'i shkëmbit,/e qëllon topi i Zallëmit,/Na prishi lezet e vëndit,/Kurvelesh o gur i thatë,/Luftuat me një rigatë,/Luftë burrat, luftë gratë". Atje ku nuk ka dokumente, në popull ka patjetër këngë që kanë shkruar historinë.

VAJZA, FSHATI AMANT I HISTORISË, TRIMËRISË, MENÇURISË

Vajza është një nga fshatrat me qytetërim të hershëm, e shquar në histori nga ilirët e deri më sot, ku historia, tradita, trimëria e mençuria, fshat ku nektari i këngëve të Ali Asllanit u përhap në mbarë shqiptarinë. Fshati Vajzë me histori thellë në rrënjët iliro-amantine ka lindur dhe rritur burra e gra atdhetarë dhe kjo vërtetohet në të gjitha periudhat historike të zhvillimit. Në kryengritjet e trevës labe Vajza ka pasur vazhdimisht përfaqësuesit e saj. Masakrat dhe sjelljet çnjerëzore të pushtuesve sikurse kanë qenë masakra e Manastirit, kur serasqeri i Rumelisë/ Ballkanit Mehmet Reshit Pasha për të zhdukur gjurmët e lëvizjes shqiptare kundërosmane organizoi një masakër çnjerëzore gjakatare më 9.8.1830. Në Manastir u thirrën krerët e Toskërisë, gjoja "për t'ju dhënë rrogat e prapambetura nga lufta greke", por i pritën me një batore pushkësh që vranë në mënyrë çnjerëzore dhe të pabesë 500 të ftuarit shqiptarë dhe kokat e tyre i dërguan në Stamboll si fitore të madhe osmane. Pabesia osmane nuk u harrua kurrë dhe u shkrua si faqe e zezë e pushtimit, që u transmetua në breza tek shqiptarët. Asnjë dredhi osmane dhe as gjaku i derdhur lumë nga krerët e kryengritjeve nuk i trembi dhe nuk e mposhti Labërinë dhe krejt shqiptarët. Këtë e vërteton më së miri veprimtaria e viteve 1830-1847 ku zjarri i kryengritjeve antiosmane u ndez në jug dhe në veri të Shqipërisë. Vitet e Rilindjes e veçanërisht ato të pas luftës ruso-turke të 1880-1878, një numër i madh patriotësh të ndërgjegjësuar për periudhën e vështirë që kalonte vendi u mblodhën rreth patriotit dhe trimit Hito Zenel Hitaj dhe bashkë me të dhe Sulejman Kapo Hoxha, Karafil Brahim Brahimi, Nuro Xhelali, Çize Merko, Devoll Sadushi, Nuredin Boraj, etj. Ata u shndruan në bërthama e kundërshtimit me forcë të taksave të larta, të xhelepit, të dërgimit të djemurisë së Vajzës dhe mbarë Labërisë nizamë në vist më të largëta të sulltanatit osman.

LABËRIA VENDI KU FËMIJËT BURRËRRO- HEN PARA KOHE

Hito Hitaj ishte lindur në oxhakun e Zenel Hitaj në pranverën e 1830, në mëhallën "Karavoq" në Vajzë të Vlorës. Si në gjithë Labërinë dhe në fshatin Vajzë fëmijët nuk kishin kohë ta jetonin fëmijërinë. Djali që lindi në familjen e dëgjuar të Zenel Hitaj



ishte një jatagan dhe një pushkë e stërralltë për të mposhtur hallet e kohës dhe për të mbijetuar pushtimit të gjatë osman. Që fëmijë provoi peshën e halleve që ishin halle për të jetuar e mbijetuar përmes skamjes e fukarallëkut, por dhe përmes rrebelimit të vijueshëm antiosman dhe kundër çdo pushtuesi, ku kundërshtojë me të gjitha format pushtimi. Hito Hitaj, i përkiste një familje me tradita të shquara patriotike dhe atdhetare, që jataganin e dyfekun e kishin për zanat si gjithë Labëria. Vatra e ngrohtë familjare e mëkoi me traditën gojore të këngëve, papërkulshmërisë dhe revoltave të të fshatit Vajzë dhe mbarë trevës luftarake të Labërisë. Vajzotët ishin optimistë dhe në kohë pushtimi, Tregimet, këngët, historia e rriten djalin e Hitajve, edhe pse ai u bë bujk e blektor. Ishte djalë i shoqërueshëm me moshatarët, që u rrit livadheve e ujrave të kristalta të Vajzës. Lojrat me bashkëmoshatarët si mundja, vrapimet, kërcimet, gjuetia e forcuan djalin e fshatit Vajzë dhe të Labërisë, e bënë në të vërtetë një shkëmb labërie në përballimin e halleve familjare, fshatit, mbarë krahinës. Shpejt u burrërua dhe i doli në krahë familjes në punët e fushës dhe të malit, por nuk harroi asnjëherë jataganin e dyfekun, traditën labe si postulat i shekujve për mbrojtje.

Në vitet 1850 kreu detyrën e nizamllëkut në bazë të ligjit osman (nizamë-rend, rregull, ligj), dhe pasi i shpëtoi gjallë shërbimit ushtarak shtet vjeçar në shumë vende të Anadollit e Jemenit, erdhi në fshatin e lindjes, në Vajzë, krijoi familje dhe e rriti oxhakun e Hitajve, në Karavoq. Hito Hitaj ishte një zë burrëror i fjalës dhe i besës në Vajzë, ishte jo vetëm i pushkës e jataganit, prijës e luftëtar i sprovuar dhe që nuk i trembej syri. Ishte një orator i spikatur që ngrinte peshë zemrat e bashkëfshatarëve dhe të krahinës kundër pushtimit. Aktiviteti i tij kundërshtues ndaj rregjimit është rregjistruar në kujtesën historike të brezave si një prijës dhe luftëtar që shkatërruan karakollet/postobloqet, shembën kubënë/vendin e shenjtë, të ngritur në Karavoq dhe gurët i përdorën për ngritjen e shtëpive dhe pllakat e gurit për të shtruar lëmin ku shihej bereqeti me kuaj në Vajzë të Vlorës. Aktiviteti patriotik i fshatit Vajzë edhe nën frymën e LSHP-së mori përmasa të mëdha dhe më të organizuara, por që kulmon me vrasjen në Vajzë të kryetrimt, prijësit, luftëtarit dhe organizatorit të rrebelimeve dhe kryengritjeve të fshatrasisë së zonës Hito Zenelit në

vjeshtët e vitit 1878. Kuvende të shumtë në Labëri dhe në treva të tjera shqiptare kishin sjellë në vëmendje mbarëpopullore, ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, që një stacion krenarie është Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ndërkohë që aktiviteti kundërshtues vijonte në të katër Vilajetet shqiptare.

TRIMAT NUK VDESIN, ATA NGELEN NË KËNGË

Aktiviteti i pandërprerë kundër pushtimit në Vajzë, në Labëri dhe më gjerë lidhej me platformën e Rilindjes kombëtare, për gjuhën shqipe, dhe të drejta të tjera të shumta të mohuara, për të lehtësuar popullatën e varfër nga taksat dhe taksidarët që i rrëmbenin fshatërsisë deri edhe kafshatën e fundit. Një problem tjetër madhor ishte edhe administrata të tishite shqiptare, gjyqtarët gjithashtu dhe gjithë sistemi i drejtësisë dhe për më tepër djemtë shqiptarë ta kryenin ushtrinë në trevat shqiptare. Në ato vite kishte një anije/gemi me emrin "Daut", që mbushej me djem shqiptarë për të bërë ushtrinë 7 vite në viset më të largëta të perandorisë osmane. Nuk ishin pak por çdo vit 14 mijë djem askerë në të gjithë sanxhaqet/prefekturat e Shqipërisë në Rumeli. Ndërkohë që kur dolet osman lëshonte kushtrim "Vatan koruma için/për mbrojtjen e vatanit" në "harb zamani"/ kohë lufte, numri i të mobilizuarve sërish rritej që përfshinte dhe redifët/ rezervistët e vullnetarët. Gemia "Daut", ishte bërë një emër i njohur për skelat bregdetare shqiptare të Shëngjinit, Durrësit, Vlorës e Sarandës sepse çonte në kazemat ushtarake të Portës së Lartë "ajkën e djalërisë" shqiptare, në zbatim të "fermanëve" famëkeqe, që Sulltanati mbushte radhët ushtarake për të mbajtur pushtetin e pushtimit me gjak, me zjarr e hekur. Në brigjet shqiptare e qanin "Anija e Dhembshurisë", të dhimjes e dashurisë, të mallëngjimit e shpresës, sepse ndër vendet ku shërbenin arnautët ishte edhe Jemeni sikurse ishte çdo pikë e sulltanatit në 8 milionë km² në tre kontinente. Jemeni njihej në popull nga këngët popullore... "Ah o Jemen,/trëndafil prej bari,/vallë kush shkon,/pse nuk kthehet më për së gjalli?". Ndërkohë luftëtarë sy-patrembur të Vajzës u bashkuan Çize Markua, Sulçe Sulçaj, Nuro Xhelali, Devoll Sadushi, Hito Hitaj, Nazo Nazaj e shumë luftëtarë të tjerë vajzotë. Kjo periudhë deri në vitet që pasuan është e mbushur me ngjarje të mëdha për fshatin Vajzë. Taksiderët e sundimtarëve osmanë të shoqëruar nga xhandarët, kërkojnë me çdo kusht të paguhen xhelepet, por disa herë ata ishin përzënë me forcë nga ana e fshatarëve të Vajzës dhe mbarë krahinës, një betejë e përherëshme e Labërisë me pushtuesit.

Ngjarja më e hidhur dhe indinjata më e thellë ishte ajo e vrasjes së Hito Hitajt nga xhandarët osmanë në fshatin Vajzë në 12 të vjeshtës së dytë (tetor) të 1878-tës. Hito Zenel Hitaj ishte prijës dhe luftëtar i sprovuar, kundërshtar i paepur i pushtimit si dhe nismëtar për të mos paguar as taksa dhe për të mos dërguar ushtar mish për top për sulltanatin osman. Për këtë arsye edhe ishte vënë në qendër të koshareve osmanë dhe taksidarëve si një ndër rrebelët dhe kundërshtarët që i hapte punë pushtuesit. Por nuk e lejonin të ishin të lirë në punën e vet. Protestat e vajzotëve për raprezaljet, shtypjet nga ana e të dërguarve të sulltanëve, arritën deri tek valiu i Janinës, por më kot, asgjë nuk u mor parasysh, përkundraz, vuajtjet e popullit nën robërinë osmane sa vinin e shtoheshin. Fshatarët patriotë vajzotë nën udhëheqjen e Karafil Brahimajt e Sulejman Hoxhës formuan një çetë prej më tepër se 30 veta, që nganjëherë kur bashkoheshin me fshatrat e tjerë bëhej një uragan i papërbalueshëm nga trupat pushtuese, dhe këto rrebelime popullore në trevën labe dhe jo vetëm ishin të shumta dhe të konsiderueshme. Formimi i çetës ishte një nga ngjarjet më të

(Vijon në faqen 11)

IN MEMORIAM

Elezi e thoshte shpesh se gjysma e tij ishte në Shqipëri dhe pjesa tjetër në Kosovë

Lamumirë Elez Dervishi, veterani 90 vjeçar nga Kryeziu i Pukës

• *Veterani Elez Dervishi që u nda nga jeta plot tallaze, ka marë pjesë në luftën Nacional-Çlirimtare. Kjo luftë që dielli i Kunorë Dardhës për të. Pas mbarimit të shkollës punoi si ekonomist në Fushë Arrëz e në disa fshatra të kooperativave bujqësore. Ndershmëria në punë e nxori kurdoherë faqebardhë*

Nga Sefer PASHA

Si njeri i letrave jam kundër skemave qoftë dhe për një skicë apo poezi me katër vargje. E dua artin kur ai godet në shënjë. Po i hedh këto rreshta në letër që nga lokal "Sharri" në Prizren për mikun tim Elez Dervishi me origjinë nga Kabashi i Pukës. Miku im qenka ndarë nga jeta në moshën 90 vjeçare. Fshati i lindjes së Elez Dervishit është Kryeziu i Pukës. I kam rënë pashë më pashë Kryeziut që nga Ura e Bardhetit në Fushë Arrëz e deri në Kunorë Dardhë nga ku duket Gjakova. Tregimet e Elez Dervishit më kanë mahnitur. Herë rrjedhin të qeta e herë me dallgë ashtu si lumi magjik i Kryeziut.

Vetëm kafeja nuk bëhet në Kryezi më thoshte Elez Dervishi tek bisedonim e pinim nga një gotë raki tek kullat e tij mbi Arën e Epërme, ku ai kishte lindur. Elezi më pati çuar tek gështenja shekullore, ku kishte folur me malësorët deputeti i Lumës Avni Rustemi. Ai i nxirte fjalët e zemrës si ato flokët e borës që bien në Kunorë Dardhë. Gjithashtu Elezi më

tregonte se në Kryezi kishte ardhur disa herë Migjeni. Me emocione më çoi në mëhallat e myslimanëve dhe të krishterëve, ku Migjeni fliste e shkruante për Legjendën e Misrit të përshkruar me mjeshtri tek "Novelat e Veriut". Elez Dervishi e dinte përmendësh skicën "Legjenda e Misrit" të Migjenit. Edhe në bisedat më të thjeshta ai citonte frazën e Migjenit: "Një kokërr misri asht një kokërr dhimbje, kur ka shumë u e aspak misër".

Mëhalla e Elez Dervishit është në verilindje të Kunorë Dardhës. Për shkak të pozicionit gjeografik aty janë strehuar Bajram Curri, Hasan Prishtina, Azem Galica e trima të tjerë të Kosovës. Elezi në prezencë të djalit Bashkimit dhe të nipit Bilbil Dervishit i prekte me dorë gurët e kullës së Nuhi Dervishit, ku ka qëndruar me muaj Bajram Curri.

Trimat e Bajram Currit ishin të lart si shkëmbinj. Kur shkonin për të bërë dru trimat, lisat e malit vetëm sa i sharronin për fundi. I hidhnin në supe sikur të ishin hunj. Dhe kur zbrisnin që nga Qafa e Benës dhe Shkëmbi i Ndrikullave dukeshin sikur të gjithë pyllin po e zbrisnin nga mali për në mëhallën e Dervishajve, ku delte dhe i priste duke qeshur Bajram Curri. Pylli i Qafës së Benës zbriste si një ushtri.

Kur Elez Dervishi ishte djali i ri shkonte tek miqtë në Gjakovë. Djemtë gjakovar e çonin dhe së bashku hanin qershi poshtë Çarshisë së Gjakovës. Dhe Elezi si mjeshtrë në të treguar u thoshte djemëve se qershitë e Malësisë së Gjakovës i kanë mbjellë zogjtë e Kryeziut.

Poshtë mëhallës ku kishte lindur ishte vreshti me qershi, të cilat i kishte mbjellë Shtjefën Gjeçovi, i cili rrënjët i ka në Kryezi. Zogjtë e Kryeziut siç ja kishin treguar të parët e Dervishajve i merrnin qershitë me sqep dhe bërthamat mbinin në arat dhe në bjeshkën e Gjakovës. Dhe kështu qershitë e Kryeziut bëheshin pyll. Janë dhe sot e kësaj dite.

Veterani Elez Dervishi që u nda nga jeta plot tallaze, ka marë pjesë në luftën Nacional-Çlirimtare. Kjo luftë që dielli i Kunorë Dardhës për të. Pas mbarimit të shkollës punoi si ekonomist në Fushë Arrëz e në disa fshatra të kooperativave bujqësore. Ndershmëria në punë e nxori kurdoherë faqebardhë.

HITO ZENEL HITAJ, KAPEDANI I LABËRISË QË NUK E TREMBI EKZEKUTIMI

(Vijon nga faqja 10)

rëndësishme në historinë e fshatit Vajzë. Komandant i çetës u caktua Çize Merko Brahimaj, që ishte edhe më i përgatitur nga ana ushtarake, pasi kishte shërbyer disa kohë në ushtrinë osmane me gradën ushtarake të "Çaushtit", por që e kishte braktisur ushtrinë osmane sepse kishte vlarë një oficer osman. Ai po ecte në rrugën e prijësit dhe luftëtarit të vlarë nga osmanët Hito Zenel Hitaj. Veprën e trimërisë dhe krenarisë së fshatit Vajzë Hito Zenel Hitaj, e pasuan edhe trimat e tjerë në vitet pas Lidhjes Shqiptare e deri në shpalljen e pavarësisë. Edhe pas ekzekutimit barbar dhe të pabesë të Hito Zenel Hitaj nga osmanët nuk mundën ta shuanin frymën e revoltës antiosmane në popull që solli deri në ngritjen e një çete patriotike luftëtare për të luftuar pushtimin osman. Pra vrasja e trimit Hito Hitaj e ngriti edhe më lartë frymën kundërshtuese ndaj pushtimit jo vetëm në Vajzë dhe në Labëri, Vlorë, Tepelënë e Gjirokastrë, por në mbarë Vilajetin e Janinës. Trimëria shqiptare sa herë ka pasur vrasje është lartësuar frymëzimi dhe kënga. Por një ndër këngët që është kënduar përreth një shekull e gjysëm në Labëri është ajo që i këndohet trimit Hito Hitaj. Kënga thotë: "Moj mëhalla e Karavoqe, / Dy herë nga turqit u dog-

je, / Hito Zeneli me famë, / Nga Karavoqajt në Vajzë, / I dërgon Pashait fermanë, / Vajza s'pranon taksidarë, / Dhe vërsulet si fajkua, / Në brinjë në Allatua, / Ku janë ullinjët e Ymëre, / Turqit i bëri fërtele, / Hallall e paç Hito djali, / Në Stamboll të vajti nami", si dhe vargjet që shënojnë trimëri brezash të luftëtarëve: "Sulejmani me Karafilë, / Që të dy gjithë bilbilë, / Tek rrapit Krekës u mblodhë, / Me ata trimat me kordhë, / Hito Zeneli trim i rrallë, / Kordhëtar mbi kordhëtarë, / Gjakun nuk ja lanë pa marrë...". Këngët për trimat e Labërisë janë ngritur përherë, pasi trimëria ngelet në këngë si dëshmi historike e kohës, sikurse është kënduar edhe për prijësin luftëtar Hito Zenel Hitaj kapedan që nuk u harrua në fshatin Vajzë të Vlorës dhe në mbarë shqiptarinë, por shërbeu si burim frymëzimi për mbarë brezat e fshatit Vajzë dhe gjithë Labërisë. Për këtë flet Historiku i fshatit Vajzë i vitit 1980 dhe sot të rënë në betejë meritojnë nderimin me titullin e lartë "Dëshmor i Atdheut", që në Shqipëri sot e garanton juridikisht ligji nr. 109/2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", pasi është një ligj që nuk i harron të rënë e truallit arbëror. Kjo është më e pakta që mund e duhet të bëjnë brezat për të nderuar e lartësuar kombin shqiptar mes kombeve më të qytetëruara të botës.



Vitet e fundit të jetës Elez Dervishi i ndau mes Tiranës dhe njerëzve të dashur në Kryezi. Ma thoshte me lot në sy se Kryeziu mbeti pagjumësia e tij. Në blloqet e mi kam shënuar qindra tregime, pamflete, fjalë të urta, legjenda, balada, rrëfana, përfshi këtu dhe këngët e Eposit të Krshnikëve. Kur Elezi ma përfundonte së treguar një ngjarje e mbyllte me vargun epik të Eposit të Kreshikëve: / Atje s'kam kan' / / Kështu më kanë than' /.

Elez Dervishi ishte një krijues i lindur. Arti gojor i tij të mahniste. Çuditë se si ai nuk shkroi si të gjithë rapsodët e malësisë. Në rininë e tij e ndjente në pyll që nga larg "llavën" e ujërave. Fryma e tyre nëpër pyll formonte një "llavë" si të vullkanëve thoshte ai. Kjo "llavë" e përkundëte pyllin sikur të frynte ndonjë ciklon.

Malësorët e dëgjonin në odë dhe e dëgjonin Elez Dervishin të çuditur. Tregimet e tij nuk kishin të sosur. Në shpatin e Kunorë Dardhës kullosnin qindra krer me dhi. Një ditë prej rrëzës së malit del një varg i gjatë me ujqër. Nga maja e shkëmbit i shikon një bari. Ishin mbi tetëdhjetë ujqër. Iknin njëri pas tjetrit. I printe një ujë i madh i kuqërremtë. Tufa e dhive u hap në të dy anët e shpatit të Kunorë Dardhës. Aty afër nuk kishte as qen dhe as barinj. Ujqërit nuk shkëputeshin nga vargu i gjatë për të ngrënë ndonjë dhi. Ata vraponin pas "komandantit" ujë. Ai i disiplinonte pa e kthye kokën mbrapa. Këtë tregim të jetuar Elez Dervishi e lidhte me botën e njeriut. Shpesh njeriu është më i keq se ujku thoshte me trishtim.

Tregimet e Elez Dervishit kishin shije dhe lezet. Ai u nda nga kjo jetë duke lënë një emër të nderuar tek familja dhe ata që e kanë njohur. Qe njeri gojëmbël. Edhe në moshë të thyer merrte shkopin në dorë e shkonte tek miqtë në Pukë përfshi dhe Zyber Djaloshin në Qerret. Ai do të kujtohet si njeri i mirë. Njeri i zakanoit, i besës dhe i atdheut. Edhe kur që i sëmure në shtrat, kur i biri që i rrinte tek koka, Bashkimi, i tregoi për vrasjen e heroit Afrim Bunjaku, Elez Dervishi derdhi lot. Elezi e thoshte shpesh se gjysma e tij ishte në Shqipëri dhe pjesa tjetër në Kosovë. I tregoi të birit Bashkimit dhe Bilbilit se mbi kullat e tyre në Kryezi janë edhe sot "muret e serbit". Nuk duhet t'i harrojmë kurrë. Ujë i Lumit të Kryeziut mund të flerë, por serbët e Vuçitit nuk i mbyllin sytë. Po i mbyll këto shënime i troditur nga vdekja e mikut tim Elez Dervishi. Shpiti më gurgullon si lumi i Lumbardhës poshtë meje. Elez Dervishi nuk do ta lexojë librin tim në dorëshkrim "Pranverë tek Zotnitë e Dervishajve në Kryezi". Aty janë dhe kujtimet e tij për Allaman Dervishin, Dëshmorin e Atdheut, i cili u vra në luftë për vendosjen e rendit në Shqipëri.

DOSSIER

Refleksione nga leximi i librit “Histori e Zbulimit Ushtarak Shqiptarë” të autorit Mehmet Musaj

Zbulimi ushtarak shqiptar, historitë e patreguara të shërbimit inteligjent të ushtrisë

GANI ELEZI

Në datën 8 nëntor 2023 në sallën “Unesco” të Muzeut Kombëtar u prezantua libri “Zbulimi Ushtarak Shqiptar” i autorit Mehmet Musaj.

Ishte kënaqësi për mua të isha pjesë në prezantimin e këtij libri.

Në këtë rast mu dha mundësia të mbaj një diskutim në lidhje me përmbajtjen dhe vlerat e këtij libri, çka po e prezantoj në këto shënime.

Prezantimi i këtij libri që po bëjmë sot është nderim për autorin Mehmet Musaj, drejtor i drejtorisë së zbulimit të MM, cili nuk arriti ta shihte botimin e këtij libri. Ky promovim është homazh për kujtimin e tij. Po ashtu është një vlerësim për kuadrot zbulues Hilë Lushaku, Vladimir Ndreaj dhe Nazmi Çela të cilët e bënë të mundur botimin e këtij libri.

ZBULIMI USHTARAK NË VITE

Zbulimi ushtarak si element, si faktor i domosdoshëm e shumë i rëndësishëm për njohjen dhe analizën e realiteteve politike, ushtarake, gjeografike e demografike në kohë e situata të caktuara.

Është sjellë ky argument me shume fakte e të dhëna për shërbimin e zbulimit në periudha të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar kombi ynë, si është periudha e heroit tonë kombëtarë Gjergj Kastrioti Skënderbeu, periudha e Bushatllinjëve të Shkodrës, ajo e Ali Pashë Tepelenës, Luanit të Janinës, periudha afatshkurtër e qeverisë së Ismail Qemalit, periudha pas pavarësisë dhe ajo e mbretërisë së Ahmet Zogut.


Pavarësisht nga përberja në strukturë, nga vartësia, nga njerëzit dhe mjetet që kanë patur në dispozicion grupet, nënrepartet, repartet e ngarkuara për zbulim dhe informacion, çka janë spjeguar në libër, ajo çfarë insiston të spjegojë Mehmet Musaj në shënime të tij në këtë pjesë është rëndësia dhe domosdoshmëria e njohjes së kundërshtarit dhe e faktorëve që e ndihmojnë apo e pengojnë atë në një konflikt ushtarak. Pra rëndësia dhe vlerat e zbulimit ushtarak.

Në mënyrë më të plotë na është dhënë historia, aktiviteti dhe kontributi i zbulimit ushtarak në kuadër të LANÇL, si pjesë, si shërbim shumë i rëndësishëm në strukturat e UNÇL shqiptare. Sigurisht kjo ka lidhje me faktin se LANÇL është zhvilluar në bashkëkohësi me disa nga kuadrot e herëshëm të zbulimit ushtarak dhe me faktin tjetër se për këtë luftë kemi shumë kujtime dhe dokumente të shkruara.

SHËRBIMI PAS LUFTËS

Zbulimi ushtarak pas përfundimit të L2 B deri në fillim të viteve 90-të.

Sa kam kuptuar nga leximi i librit mund të them se kjo pjesë është kontributi më i madh i Mehmet Musajit në



përpjekjen për të shkruar historinë e Zbulimit Ushtarak shqiptarë.

Këtë mendim e mbështes në disa argumente.

Së pari, kapitull pas kapitulli libri na njeh me situatat politike dhe ushtarake të cilat kanë kushtëzuar parimet dhe synimet e politikës sonë të mbrojtjes, të strategjisë sonë ushtarake, të artit operativ e atij taktik e për rrjedhojë edhe detyrat e zbulimit ushtarak. Libri na njeh me detyrat, me strukturën e zbulimit ushtarak në qendër, në MM dhe në njësi e reparte. Mbase shumë gjera nuk i kemi ditur. Kështu psh është fakti që pas L2B në MM zbulimin ushtarak në fillim e drejtonte një seksion zbulimi, më vonë një degë zbulimi e më vonë Drejtoria e Zbulimit apo Drejtoria e Dytë si e kemi njohur neve. Po kështu sillen të dhëna, urdhëra, data kur janë krijuar bërthamat, elementët, nënrepartet e parë të zbulimit me trupa, të radiozbulimit, të informacionit, të zbulimit të jashtëm, të kriptanalizës, etj.

Së dyti, duke na sjell në vëmendje ndryshimin e herëpashërshëm të situatave politike dhe ushtarake Mehmeti na ka spjegua domosdoshmërinë e ngutëshme, urgjente të përmirësimit, të përsosjes së strukturës, të paisjeve e të metodave të punës të shërbimit të zbulimit ushtarak për t'u përgjigjur këtyre situatave, për t'u përballur me rreziqet që paraqisnin ato për vendin tonë. Situata të tilla të cilat i përmend Mehmeti kanë qenë:

Përballimi i aktivitetit armiqësorë e kriminal i aktorëve dhe qarqeve antishqiptare që synonin rrëzimin e pushtetit të pas luftës dhe copëtimin e Shqipërisë. Prishja e marrëdhënies me Jugosllavinë, çka solli intensifikim-



in e veprimeve armiqësore të qarqeve antishqiptare serbe kundër vendit tonë.

Provokacionet e monarkofashistëve grekë në gusht të vitit 1949 dhe synimet shoviniste të qarqeve voriepirote greke.

Ndërprerja e marrëdhënies me BS dhe politika antishqiptare e udhëheqjes Hrushoviane.

Denoncimi dhe dalja nga Traktati i Varshavës pas sulmit të këtij traktati kundër Çekosllovakisë dhe rreziku i një sulmi të tillë edhe kundër vendit tonë.

Vitet e luftimeve me Izraelit dhe disa vende arabe.

Periudhat e rritjes së prezencës së Flotës së 6-të të Amerikës e të NATO-s si dhe të Traktatit të Varshavës në Mesdhe.

Periudhat kur FA të Greqisë a të Jugosllavisë ngriheshin në prova gatishmëria dhe stërvitje me trupa.

Ripërcaktimet të detyrave dhe strukturave të zbulimit ushtarak kanë ndodhur sa herë ka patur ndryshime të strukturës së Forcave tona të Armatosura. Psh me kalimin nga ushtria partizane, në strukturën e korparmatave, më vonë në atë të divizioneve, përsëri në strukturën e Korpusve e përsëri në atë të divizioneve në vitin 1983.

Si një situatë që ndikoi në ripërcaktimin e detyrave, të strukturës e të metodave të punës së zbulimit ushtarak Mehmeti kujton edhe ngjarjet e fundit vitit 1974, kohë kur u dënua udhëheqja e lartë e MM, në këtë rast edhe udhëheqja e Drejtorisë së Zbulimit Ushtarak.

Së treti, libri është një histori e gjallë e të gjithë elementëve të zbulimit ushtarak. Të seksionit, të degës, të drejtorisë së zbulimit në MM; të shërbimit të informacionit; të zbulimit të jashtëm,

të zbulimit me trupa; të radiozbulimit; të kriptanalizës e të elementëve të tjerë. Na është sjellë kjo histori me anë të dokumenteve arkivorë, me anë të kujtimeve dhe të shumë skemave sqaruese të strukturës së zbulimit ushtarak.

Mehmeti në gjithë shënime të tij ka folur më shumë për disa sektorë të zbulimit ushtarak.

Ka shkruar shumë për Radiozbulimin i cili në fakt ka qenë sektori që në kohë paqe ka siguruar të dhëna të shumta dhe të sakta për strukturat, gjendjen, përhapjen dhe qëllimet imediate të kundërshtarëve tanë. Radiozbulimi është një histori me të vërtetë mbresëlënëse. Nisur nga dy grupe radiomarrëse të D5K në Korçë dhe D8K në Gjirokastër struktura në përberje të këtyre divizioneve shumë shpejt në vitin 1951 në bazë të urdhërit të shefit të Shtatmadhorisë të ushtrisë shqiptare, gjeneral major Beqir Baluku u ngrit në shkallë ushtrie me krijimin e Kompanisë autonome të radiondërlidhjes të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, e quajtur Rep. Usht. 2908 me kuadrot e parë Izet Zaçe, Bajram Sinani, Zenel Koshaj, Sotir Tiko, etj. Nga kjo bërthamë Radiozbulimi çdo vit u riorganizua dhe u plotësua me reparte të tjera të këtij shërbimi. Në shpërndarjen, paisjen, përgatitjen dhe përgjegjësitë e këtyre reparteve u zbatua parimi i shtetit objekt zbulimi. Në bazë të këtij parimi u përhapen reparte radiozbulimi në drejtimin e Greqisë në Sarandë, në Bureto, në Postenan, në Moravë. Në drejtimin me Jugosllavinë në Shishtavec, në Tarabosh, në Shtoi. Në drejtimin me Italinë në Kavajë, në Sazan, në Dhërmi, etj. Më vonë radiozbulimi u përforcua me disa reparte me kapacitete të mëdha përgjuese si reparti Radiozbulimit në Krujë dhe ai në Kaninë në Vlorë. Me aktivizimin e këtyre reparteve sasia dhe cilësia e të dhënave të grumbulluara u përmirësuan si në dispozitiv gjeografik ashtu edhe në përkatësinë e tyre, pra më zgjerimin e objekteve të përgjuara. U vu në kontroll gati gjithë hapësira e Mesdheut dhe e Evropës Jugore, forcat e NATO-dhe ato të Traktatit të Varshavës. Më vonë u aplikua edhe metota e përgjimit shëtitës. Radiozbulues të përgatitur punonin në anijet tona që shkonin e vinin nga Kina e kryesisht ato që ankoroheshin në portet e Mesdheut. Një kontribut të madh në shërbimin e Radiozbulimit ka dhënë shkolla e radiozbulimit, Rep. Ushtarak 2942, i cili çdo vit përgatiste radiozbulues për të gjithë drejtimet, sipas shteteve kufitare me. Në vitin 1980 kjo shkollë përgatiti kursin e parë të punonjësve civilë, djem e vajza, të cilët punuan pandërprejë në radiozbulim, çka e ngriti edhe më lart profesionalitetin dhe efektivitetin e shërbimit të Radiozbulimit.

Repartet e Radiozbulimit i kanë siguruar qeverisë shqiptare, Këshillit të Mbrojtjes dhe Komandës së Përg-

DOSSIER


(Vijon nga faqja 12)

Zbulimi ushtarak shqiptar, historitë e patreguara të shërbimit inteligjent të ushtrisë

jithëshme të dhëna shumë të vlefshme mbi të cilat këto institucione kanë marrë vendime shumë të rëndësishme për garantimin e mbrojtjes së vendit. Në këtë vlerësim Mehmeti ka të drejtë. Ndërsa zbulimi me trupa mund ta provonte aftësinë, profesionalitetin vetëm në kushte lufte, çka nuk ndodhi këto vite, dhe më mirë kështu se lufta do sillte pasoja të rënda për popullin tonë, shërbimi i Informacionit, ai i zbulimit të jashtëm, e më shumë Radiozbulimi ka qenë vazhdimisht në luftë. Radiozbulimi ka qenë në luftë që nga fillesa, që nga grupet e radios të D5K dhe D8K në vitin 1948 dhe deri në fillim të viteve 90-të. Tani nuk kam dijeni në se ekziston si zbulim dhe çfarë bën.

Por, po aq me vlerësim Mehmeti ka shkruar edhe për zbulimin me trupa. Ka spjeguar se në kohë lufte ky zbulim ishte me rëndësi të madhe për sigurimin e të dhënave për armikun. Zbulimi me trupa është konsideruar si shërbimi më efikas i zbulimit në kohë lufte. Pas çlirimit të vendit ky shërbim u organizua në çdo njësi të nivelit DK, BrK, RK. Domosdoshmëria e këtij shërbimi doli në pah sidomos në ditët e provokacioneve greke në kufirin me Greqinë. Në faqet e librit mësojmë edhe një fakt, për të cilin unë, por edhe shokët e mi të Dzb kishim dëgjuar nga Taqo Kovaçi. Në ditët e provokacioneve greke në Korçë nga ana e komandës shqiptare janë organizuar grupe zbulimi për kalim në prapavijat greke për kapje robërisht. Një praktikë e cila më vonë nuk është përdorur më.

Është kjo përvojë që e detyrojë Komandën e Përgjithëshme të Ushtrisë shqiptare që në periudhën 1950-1955 të insitohet në riorganizimin dhe përgatitjen e reparteve të zbulimit me trupa në njësitë e brezit të parë të mbrojtjes. Në këtë rrugë, në vitin 1956 është krijuar kompania e zbulimit me trupa, e quajtur Rep. Usht. 1152, në dorë të Sh P të ushtrisë sonë, me disa kuadro të njohur të zbulimit ushtarak si Shahin Leka, Kutel Çino, Fran Doda, Viktor Dhroso, etj. Kjo kompani është paraardhësja e Dzb të SHP të FA, i cili u kthye në një laborator përvojë e përgjithësimi për ngritjen e nivelit e të cilësisë së përgatitjes luftarake për gjithë gjithë repartet e zbulimit me trupa e në të njëjtën kohë edhe për armët dhe shërbimet e tjera të ushtrisë. Për faktin se zbulimi me trupa në kohë paqe mund të kryente vetëm detyra vrojtimi në distanca të afërta, detyrë që e plotësonte vetëm me mjete



pamore, përgatitja e tij me shumë synonte në aftësimin e trupës së zbulimit për veprime në kohë lufte. Plotësimi i detyrave të zbulimit në kohë lufte, detyra zbulimi por edhe detyra sulmi kundër objekteve të rëndësishme të kundërshtarit, kërkonin një përgatitje të madhe morale, fizike dhe profesionale. Është kjo arsyeja që programi i përgatitjes se reparteve të zbulimit me trupa ishte shumë i ngarkuar dhe shumë i vështirë. Përgatitje në poligone speciale, përgatitje për veprime në verë e në dimër në kushte dëbore, përgatitje për mbijetesë, veprime luftarake me ski, përgatitje dhe hedhje me parashutë në rajonet e detyrave luftarake, përgatitje për përdorim të mjeteve eksplozive, veprime në kushte maskimi për një kohë të gjatë, kalim pengesash ujore, etj ishin prova të mëdha për repartet e zbulimit me trupa, prova që i kanë kaluar me sukses.

INFORMACIONI, SYRI DHE VESHI I KOMANDËS

Në librin "Zbulimi ushtarak", Mehmeti ka shkruar për punën e madhe të

Degës së Informacionit të Drejtorisë së zbulimit, e cila ishte një element shumë i rëndësishëm për grumbullimin dhe sidomos përpunimin e informacioneve për institucionet e sigurisë e të mbrojtjes. Duke u mbështetur në burime e materiale legale por edhe burime e materiale konfidente, sidomos në të dhënat e Radiozbulimit dhe të zbulimit të jashtëm, kjo degë i siguronte SHP të Ushtrisë, Komandës së Përgjithëshme, Këshillit të Mbrojtjes por edhe institucioneve e ministrive të interesuara informacione të shumta në lidhje me situatat politike dhe ushtarake në rajon a në shkallë globale e veçanërisht për rreziqet që paraqisnin për vendin tonë këto situata. Po ashtu mbi bazën e të dhënave nga elementët e ndryshëm të zbulimit ushtarak kjo degë përgatiste materiale teorike, manuale për përbërjen, strukturën, kapacitetet ushtarake, për konceptet strategjike, operative e taktike të ushtrive të cilat mund të sulmonin vendin tonë. Në këtë kuadër kjo degë kishte një kontribut të madh edhe në përgatitjen e kuadrove të nivelit të lartë që studionin në Akademinë tonë Ushtarake.

Pa u futur në emra dhe të dhëna konkrete, të cilat për arsye të karakterit ende sekret të tyre nuk mund të bëhen të njohur, Mehmeti ka shkruar edhe për shumë kuadro të zbulimit që kanë punuar në shërbimin tonë diplomatik. Sigurisht përpos detyrave të tyre diplomatike këta kuadro zbulimi kanë siguruar të dhëna konfidente edhe për problemet ushtarake, kryesisht për organizimin, kapacitetet ushtarake të vendeve ku ata akreditoreshin e sidomos për planet e tyre ushtarake ndaj vendit tonë.

Veç këtyre kuadrove të shërbimit tonë diplomatik që kontribuonin në

mbledhjen e informatave për problemet ushtarake në përfaqësitë tona diplomatike, të tjerë kuadro të zbulimit e kryenin këtë mision duke u bërë pjesë e grupeve kulturore, sportive a delegacioneve të ndryshme që udhëtonin në shtetet që ishin objekt zbulimi për ne. Madje shpesh kuadro të tillë udhëtonin në këto vende si shoferë "plotësues" të parkut TIR Albania.

Sa kam unë dijeni në shumë raste të dhënat e këtyre kuadrove të zbulimit tonë ushtarak kanë bërë që MM, Komanda e Përgjithëshme dhe Këshilli i Mbrojtjes i vendit tonë të marrin masa për forcimin e gatishmërisë luftarake, deri në mobilizimin dhe daljen në rajonet, brezat, zonat e mbrojtjes të reparteve e njësisve të drejtimeve që mund të kërcënoheshin.

Së katërti, ky libër ka një vlerë e cila mund të quhet unikale. Është nga librat e rrallë që në faqet e tij ka kaq shumë emra. Është një arkivë, një "hipotekë" me qindra, mbase më shumë se njëmijë emra kuadros dhe punonjësish të cilët kanë punuar në zbulimin ushtarak. Në sektorin e Informacionit, në atë të zbulimit të jashtëm, në Radiozbulim, në Kriptoanalizë, në repartet e Zbulimit me trupa, në sektorin e kuadrit, të teknikës dhe të prapavijës, etj.

Evidentimi i kaq shumë emrave (mund të jenë të rrallë emrat e harruar) që kanë punuar në drejtorinë e zbulimit dhe në repartet vartëse të saj, të atyre që kanë punuar në degët, seksionet dhe repartet e zbulimit të njësisve ushtarake (KK, DK, BrK) të ushtrisë sonë, është homazh që u bëhet gjithë këtyre njerëzve që nuk kursyen asgjë, as mundin, as djersën, disa as jetën e tyre, për ta ngritur, për ta drejtuar

Drejtimi "D": Astrit Mulita (shef i drejtimit), Selim Shiroka, Guri Saliaj, Ismail Hoxha, Qerim Hola-përpunues dhe përkthyes.
Drejtimi "E": Esat Lushaj (shef drejtimi), Ramazan Zeneli (matematicien), Trifon Llupo, Selami Plepi, Shefqet Skënderi-përkthyes dhe përpunues.
Inxhinier i repartit u emërua z.Arif Tomçini.⁴⁵¹
Pas një viti efektiv i këtij u shtua edhe me dy inxhinierë: Filip Peçani dhe Vladimir Dode, si dhe me vajza të cilat sapo kishin mbaruar shkollën e mesme:

⁴⁵¹ Në këtë grup kanë shërbyer edhe punonjësit Agim Fagu, Kastriot Pëllumbi e të tjerë njohës të gjuhëve të huaja

ESSE

SALARI GRYKË E TUFANIT


Neki ÇAKO

Tek po ngjisja tatëpjetën e fortë të lagjes Deliaj të fshatit Salari në rrethin e Tepelenës, më shfaqet para sysh mali i lartë i Këndrevicës aty ku dëborat duron deri në vepër e korrikut. Poshtë në rrëzë të malit gjendet fshati Salari që qëndron si gur themeli mbi të cilin mbeshetet vetë mali. Makina rrëshket mbi asfaltin e zi të sapo shtruar nga firma "2T" me ndërtime inxhinjerin Artan Sako një bir i fshatit Nivicë. Tek afrohem drejt fshatit dhe futem në grykën e sertë të këtyre maleve më vjen ndërmend një këngë burrërishte e cila është kënduar nga grupi i fshatit Salari, ku po citoj dy vargje të saj. Kjo valle e kënduar aq bukur, që i shkon për shtat edhe veshjes, opingave me xhufkë, xhamadanit e brezit të qëndisur me fije ari, plot nur, si dhe qylafit prej shajaku, i bardhë si bora.

SALARI GRYKË E TUFANIT.

Ç'DJEM TRIMA I DHE VATANIT!

Teksa afrohem në fshat më ç'faqet busti i heroit të 1920, Selam Musait. Po aty qëndron edhe muzeu i fshatit, muzeu historik i luftës ku janë shpalosur stenda, sende e portrete të luftëtarëve dhe dëshmoreve të rënë në luftë. Jemi në prag festash e pikërisht në muajin Nëntor, muaj i cili solli lirinë. E, për të arritur këtë ditë u desh të sakrifikohej shumë deri në flijim jetësh! Ndaj e vetmja mundësi që na jepet është, që ne ti kujtojmë e të mbajmë ndezur frymën dhe të përçojmë më tej sakrificat sublime të tyre. Po le të



ndalemi pak tek Ali Xhemali Zhupa. Ai lindi në fshatin Salari. Jeta e bëri të përballë shumë shpejt me varfërinë pasi në atë periudhë vëndi ishte i zhytur në skamje dhe në mjerim të tejskajshëm. Ishte piku i urisë. Ptohtë! Këmbëzbathur i kaloi ato zeje stërralli për të ushqyer bagëtinë, por ende nuk i plotësonte nevojat për jetesë. Opin-gat me tela dhe zejet e stërrallit, sa herë ja kishin gjakosur këmbët. Por Aliu nuk jepej. Ai rendëte pas bagë-tive për të siguruar ato pak të ardhura për mbijetesë. Kështu e kaloi rininë e tij duke punuar si hyzmeqar tek agai, por kurrë nuk e shoi dotë urinë! Ali Xhemali Zhupa e kishte mbushur shpirtin plotë urrejtje! Por një ditë do të lindëte dielli edhe për të. Me lindjen e frontit nacional - çlirimtar lindi edhe shpresa dhe optimizmi në dejet e Aliut, i cili e shikonte si të vetmen shpresë për çlirimin nga pushtuesit.

Ai që në fillimet e vitit 1941 mori pjesë në operacionet legale dhe u përfshi në aksione kundër pushtuesve italianë. Pas shumë luftimeve atë e burgosën në burgun e Gjirokastrës. Mbi të ush-truan tortuara nga më monstruozet. Nëntë muaj me nofull të thyer. Me gjithë torturat Aliu nuk e zërtheu gojën dhe prej tij nuk morën asnjë të dhënë për shokët dhe bazat e luftës. Mbas burgut e morën me forcë dhe e çuan larg, e çuan ushtar në Gjakovë. Ata donin të krijonin sherr, vëllavrasje me vëllezërit kosovarë. Por Aliu tha: - Më mirë qëlluj mbi veten, sesa mbi vëllezërit e një gjaku. Duke parë këtë situatë, ai së bashku me një grup shokësh u arratis nga ushtria dhe u kthye në fshatin e tij të lindjes. Ali-un e brente ndërgegja dhe nuk rrinte dot pa u aktivizuar me lëvizjen, ndaj ai menjëherë nisi nga aksionet. Njëherë për të penguar lëvizjen e artilerisë ar-

mike së bashku me grupin e shokëve të tij, prishi urën mbi përroin e Salarisë. Ndërsa në fshatin Dukaj duke rënë në përpjekje plumbi desh e ndau nga shoqëria. U plagos rëndë. U deshën plot 7 ditë e shtatë netë të kalonte nën agoni, deri sa dha shën-ja jete. Gjaku rridhte por zemra e tij ishte atje në betejë me shokët. Pasi e mori veten, ai s'mund të rrinte pa shokët. Ju deshën tre ditë rrugë, që ti arrinte ata në Mbretzhdan të Beratit. Ai ishte i kalitur dhe që në betejat e para tregoi trimëri. I veshur me një palë opinga të mbërthyer me tela, dhe një fanellë leshi, kaloi dimër e acar, por nuk u përku kurrë nga vështirësitë. Me zemrën e tij të çeliktë do të kapërxente ç'do pengesë. Në Tiranë ai do të hidhet si fajkua mbi kazermat "Shkumbini" plot municion të armikut. Gjermanët e përshkallëzojnë sulmin e tyre duke u hedhur me forca të shumta dhe zjarr të dendur. Dikush i shkon pranë Aliut dhe e thërret. Por ai nuk do t'ja dijë. Ishte plagosur, por dora mbi këmbëzën e dyfekut nuk po i ndalonte së shtiri. Vëlla qënke plagosur. Po të rrjedh shumë gjak. Të pas-ka marrë plumbi. Prit të ta mjekoj, prit ta lidh plagën. Një vajzë fillon t'ja lidhë plagën, por nuk arrin. Duart e saj u varën si të këputura. Një plumb e kishte goditur. Buzëqesh lehtë sikur ti kërkojë, ndjesë, që nuk ja lidhi dotë plagën. Malet gjëmojnë dhe grykat i përcjellën njera tjetrës jehonen e krismave. Plumbat vërshojnë rreth e rrotull. Aliu pyet? Motër, më thu-aj si quhesh. Sose... Sose Musai më thonë! Jam nga Kallarati i Vlorës. Po buzëqesh. A nuk e sheh se plaga jote po rrjedh gjak! Jam e gëzuar që vdes, për vatanin. Njëmijë herë do ta jepja jetën për këtë vënd. Atdheu është i shenjtë, kauza jonë do të fitojë dhe vajza ra duke dhënë shpirt në krahët e tij. Plagët nuk e mposhtën trimin. Dridhu, s'ke ku shkon, o dushman! Soses do ti merret haku! Vërshonte bashkë me plumbat fjala e tij e rreptë. Mbi gjëmi-met e betejës, dhe mbi krismat e push-këve ballë për ballë me armikun. U ngrit në këmbë si rrufeja edhe pse një trup i shpuar nga plumbat, ash-tu i mbuluar në gjak me zërin e tij që bënte thirrje. Para partizanë! Për një shqipëri të lirë. Zëri i tij buçiti duke lëshuar jehonën e tij deri aty në lartësinë e maleve të Kurveleshit. Liria është e jona. Aliu ra me fjalë në gojë! Ndërsa vepra e Aliut do të nderohet e lartësohet në panteonin e lavdisë, themelet e të cilës i vulosi me gjakun e tij!

Zbulimi ushtarak shqiptar, historitë e patreguara të shërbimit inteligjent të ushtrisë

(Vijon nga faqja 13)

jtuar me sukses zbulimin ushtarak. Në këtë libër gjejmë edhe jetëshkrime dhe kontribute të drejtuesve kryesorë të zbulimit ushtarak ndër ta të Ham-it Keçit, shef i Seksionit Informativ të Komandës së Përgjithëshme në vitin 1949, të Teme Sejkos, të Vehbi Hoxhës, të Andon Shetit, të Eqerem Osmanit, të Mehmet Musait, të Kujtim Jahos të cilët kanë patur funksionin e drejtorit të Drejtorisë së Zbulimit, por edhe të drejtuesve të tjerë të lartë si Spiro Adhami, Ilo Furxhi, Xhemil Çela, Izet Zaçe, Skënder Çela, Shefqet Troqe, Xhelal Novosela, Pandi Opari, Zenel Koshaj, Lame Liti në drejtorinë e zbulimit dhe Shefqet Haxhiaj, Syrja Sinol-lari, Sali Qazimi, Ylvi Demiraj, Kujtim Lumani, Xhemali Abazi, shefa zbulimi në korpuse, etj.

ZBULUESIT ME STATUSIN E "DIPLOMATIT"

Së fundi, Mehmeti ka shkruar edhe për një fakt tjetër i cili na bën të zbuluesve krenarë. Madje ndonjëherë edhe më shumë. Doja të thosha se shpesh kjo përkatësi profesionale na bën të mburremi, mbase me tepri. Me emra të shumë ai ka zbuluar faktin se shumë kuadro të zbulimit janë dalluar edhe në sektorë të tjerë. Janë dalluar si dre-

jtues të Shtabit të Përgjithëshëm dhe të drejtorive të ndryshme në MM; si drejtues të lartë të njësive të ushtrisë, KK, në DK e njësive të tjera të mëdha. Janë dalluar në shërbimin diplomatik shqiptarë. Janë dalluar në sektorë të punës shkencore dhe akademike. Janë dalluar si krijues letrarë dhe publicistë, etj.

Duke e mbyllur këtë diskutim dua të them:

Cilido, ata që për fat ende jetojnë, çdo birë, bijë, çdo nip e mbesë që kërkon të mësojë për etërit, gjyshërit e tyre në shërbimin e zbulimit ushtarak mjafton të ketë e të futet në faqet e librit të Mehmet Musajit "Zbulimi ushtarak shqiptarë" dhe ta gjejë atë për të cilin ka mallë e dashuri.

Edhe njëherë,

Nderim për këtë punë të madhe profesionale por edhe publicitare të mikut tonë Mehmet Musaj.

PAK RADHË PËR AUTORIN MEHMET MUSAJ

Mehmet Musaj ka lindur më 10 janar 1945 në fshatin Selimaj-Geghy-sen në Tropojë. Mbasi kreu arsimin shtatëvjeçarë në vendlindje, në vitet 1951-1958, shkoi në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skenderbej" Tiranë të cilën e përfundoi me rezultate të larta në vitin 1962. Më pas në vitet 1962-1964

vijoi studimet në shkollën e oficerëve "Enver Hoxha" në Tiranë dhe u titullua oficer.

Karrierën ushtarake e filloi në Ishullin e Sazanit ku shërbeu në periudhën 1964-1968, më pas në periudhën 1968-1970 ka kryer studimet në Akademinë Ushtarake të SHP në Tiranë. Më pas vijoi karrierën ushtarake në detyrën e komandantit të repartit të Radiozbulimit në Tarabosh, Shkodër në vitet 1970-1973, pastaj komandant i repartit të Radiozbulimit në Farkë, Tiranë në vitet 1973-1974. Pas kësaj detyre në vitin 1975 është emëruar në Drejtorinë e Zbulimit të MM. Po në këtë vit është emëruar në detyrën e zëvendës drejtorit të kësaj drejtorie, funksion të cilin e ka mbajtur deri në vitin 1981. Në periudhën 1981-1991 ka mbajtur postin e drejtorit të drejtorisë së zbulimit të MM.

Pas ndryshimeve politike në fillim të viteve 90-të, me riorganizimin e FA dhe të MM u emërua në Akademinë Ush-tarake në detyrën e shefit të katedrës së zbulimit dhe të ushtrive të huaja. Në vitin 1997 Mehmet Musaj është emëruar në detyrën e zëvendës shefit të SHP të ushtrisë shqiptare, ndërsa në vitin 2001 ka dalë në rezervë e pas pak kohe është rikthyer në FA në detyrën e Këshilltarit Ushtarak i Ministrisë të Mbrojtjes.

OPINION

OKB -ja DHE MBROJTJA E SIGURISË DHE PAQES NË BOTË

SHPENDI TOPOLLAJ

Pasi Lidhja e Kombeve nuk ja doli dot të parandalonte çmendurinë e Adolf Hitlerit që pasoi me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, ku të vdekurit ishin rreth 60.000.000 njerëz, pa llogaritur të gjymtuarit, dëmet ekonomike, shkatërrimin e qytetërimeve dhe trashëgimisë kulturore të popujve, krijimi i Organizatës së Kombeve të Bashkuar, sipas idesë së hedhur qysh në Jaltë në shkurt të vitit 1945, ngjalli shpresa të mëdha në të gjithë botën, pasi në misionin e saj theksohej si detyrë parësore “ruajtja e sigurisë dhe e paqes në botë”. Por kështu si po zhvillohen ngjarjet, kuptohet se autoriteti i kësaj Organizate jo vetëm që është dobësuar, por ajo sa vjen e po kthehet në diçka formale. Aktualisht, drejtimi i saj nga zoti Antonio Guterres thuhet se është inekzistent. Mënyra sesi ajo është strukturuar, me një Këshill Sigurimi prej pesë anëtarësh të përherëshëm, Fuqi e Mëdha këto, ku secili ka të drejtën e vetos, e bën atë vetëm një tribunë debatesh pa fund, ku nuk mund të merren asnjëherë vendime të efektshme.

Nuk ka njeri që të mos e dijë se për hir të intereseve dhe influencave të tyre, dy superfuqitë, SHBA dhe Federata Ruse, janë nxitësit e konflikteve dhe përkrahësit e palëve në konflikt. Ata me politikën e tyre, janë shndërruar edhe në furnizuesit me armatime, municione, teknikë e llogjistikë të ushtrive aleate, duke ndikuar kështu në zgjatjen sa të jetë e mundur të luftës, pavarësisht kostove të pallogaritshme që rrjedhin prej tyre. Afërmendsh që mekanizmi i vetos e pengon edhe përpjekjen më të sinqertë për t'i ndaluar këto armiqësi që lindin si pasojë e mosmarrëveshjeve të vjetra e të reja të politikanëve, përdorimi si mish për top prej të fuqishmëve ose nga mbartja e problemeve të mbetura me kohë pezull. Nga ana tjetër, burokratëve të OKB - së, s'u ka mbetur tjetër veçse të bëjnë thirrje patetike për armëpushim dhe të na japin me saktësinë më të madhe, statistikat e të vrarëve. Që bota nuk ka pasur dhe nuk do të ketë ndonjëherë qetësi, këtë e ka kushdo të qartë.

Për këtë nuk kanë vlejtur as këshillat e burrave të mençur si John Kennedy i cili thosh se “Njerëzimi duhet t'i japë fund luftës, para se lufta t'i japë fund njerëzimit”. Tërhoqi vëmendjen e gjithë botës sulmi kriminal i ushtrisë putiniane



në Ukrainë. Mbarë njerëzimi e dënoi atë. Por tani edhe pse ajo vazhdon të marrë jetët e mijra e mijra njerëzve të pafajshëm, thuhet se nuk po bën ndonjë përshtypje. Jep e merr presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, por duket se askush nuk ia vë më veshin. Duket sikur nën zë, politikanët e vendeve të ndryshme, përfshi dhe ata të OKB - së, duan të thonë: “Kokat hëngshi! Ne kemi të tjera halle.

Nuk e shihni se ç'po bëhet mes Izraelit dhe Palestinës?” Ashtu është; edhe lufta mes tyre është trishtuese; por asnjë zgjidhje nuk duket në horizont edhe këtu. Askush nuk e vë në dyshim krimin e përbindshëm të HAMAS - it që i qëllon me raketa teksa festonin, rininë që vallzonte, pra që i gëzohej jetës. Asnjë të keqe nuk kishin bërë ata. Pa tjetër që Izraeli ishte plotësisht në të drejtën e tij, t'i ndëshkonte ata, qoftë edhe si hakmarrje

edhe për shkatërrimin e kësaj organizate. Por ne po e shohim çdo ditë se kjo e drejtë u tejkalua dhe tani krimet po i bën vetë Izraeli, pasi po ndodhin tmerre të pajustificuara ndaj popullsisë.

Po goditen deri edhe spitale e objekte kulturi dhe po vriten e masakrohen pa asnjë mëshirë edhe fëmijët e shkollave. Skenat me trupat e tyre të copatuara do të na mbesin gjatë në mendje. Një tjetër President i SHBA, Jimmy Carter ka theksuar një herë se “Ne nuk do të mësojmë të jetojmë së bashku në paqe duke ia vrarë fëmijët njëri - tjetrit”. Po përveç keqardhjes, çfarë po bëhet për të shpëtuar shokët e tyre vogëlushë, faji i vetëm i të cilëve është se kanë lindur në Gaza? A do të pajtoheshin me këto veprime milionat e hebrenjve që u dogjën në krematorët e Kampeve gjermane të Përqendrimit po të ishin gjallë? Janë rreth 5.000 fëmijë palestinezë të vrarë pa asnjë arsye.

Ushtarëve izraelitë në ndjekje të anëtarëve dhe udhëheqësve të HAMAS - it u është mpirë arsyeja dhe u janë errur sytë në tërbimin për t'i dhënë një mësim të mirë Palestinës, si ajo “zgjidhja finale” e Hitlerit me shokë ndaj hebrenjve paqësorë. Voltëri me një sarkazëm të hollë stigmatizonte rastet e ngjashme duke thënë “Është e ndaluar vrasja; për atë të gjithë vrasësit dënohen, përveç nëse ata vrasin në numër të madh dhe pas zërit të trumbetës”. Po kështu si po venë punët, dhe kur thirrjet për bisedime nuk po pinë ujë (se po shohim që nga ana e qeverisë izraelite që nuk marrin në konsideratë as këshillat e zotit Joe Biden), cila është zgjidhja?

Nga Këshilli i Sigurimit nuk pritet asgjë. Asamblenë e Përgjithshme të OKB - së, me 193 shtete anëtare nuk e pyet kush. Sekretarin e Përgjithshëm nuk e dëgjojnë as për krijimin e ndonjë korridorit human apo për çuarje ndihmash për popullsinë e uritur dhe me rreziqe kërcënuese për epidemi.

Për më tepër, të dërguarit e saj i vrasin pa të keq dhe objektet që ajo administron në ato vende, bombardohen pa pikën e gajles. Mirëpo, në tagrin e OKB - së është dhe ndërhyrja ushtarake për të vendosur situatën, atëherë përse ngurrohet.

Çfarë pritet tjetër të ndodhë, apo derisa të përfshihen në këtë luftë dramatike edhe vendet e tjera arabe, çka do të sillte reperkursione tragjike për gjithë njerëzimin. Nismëtarët e krijimit të OKB - së e dinin mirë se Niccolo Machiavelli qysh gati pesë shekuj më parë kishte mendimin se “Luftën mund ta fillosh kur të duash, por jo ta mbarosh”.

Pra, si do të mbarojnë këto lufta, se sot nuk luftohet me shpata, por me armë të tilla që as mendja gjeniale e autorit të “Artit të Luftës”, nuk i rrokte.

Me indiferentizmin e burrave të shteteve apo me burracakërinë e frikën e tyre? Qeveria e Izraelit dhe më konkretisht, kryeministri Benjamin Netanyahu, por edhe robmbajtësit e pashpirt duhet të kujtojnë gjestin e mbretit të kurorëzuar të Babilonisë, Sirius i cili çliroi me një dekret të veçantë hebretjtë që ishin kapur rob nga Nabunaidi, duke i lejuar ata të ktheheshin në vendin e tyre, në Jeruzalem, ku mund të ndërtonin edhe tempullin e tyre.

Kurse ata burokratët e OKB - së dhe politikanët e vendeve me ndikim, do të ishte e udhës të shkonin në Muzeun Britanik të Londrës dhe ta shihnin se çfarë shkruante ky mbret në një pllakë argjile në formë cilindri për të drejtat dhe liritë e njeriut gati 25 shekuj më parë.

Natyrisht që do të mendoheshin gjatë, por edhe do të kujtonin se ç'duhet bërë me konfliktet e atyre vendeve që kanë nisur mijra vjet të shkuara, ndofta më herët se mbretëresha e mesagjetëve, Tomirisi, sipas asaj që rrëfen Herodoti të cilin Ciceroni e ka quajtur “Babai i Historisë”, e zhyti në gjak kokën e Siriusit të vdekur si hakmarrje për vrasjen e djalit të saj.



FESTAT

Kryetari i OBVL kolonel Sotir Budina vlerësohet me çertifikatë mirënjohje për kontributin gjatë LANÇ

79 VJETORI I ÇLIRIMIT, nderojmë heronjtë që luftuan për lirinë e atdheut

• Në këtë ditë të veçantë, kryebashkiaku Veliaj nderoi 10 veteranë të LANÇ “për kontributin e pashembullt në luftën për liri, mbrojtjen e atdheut nga pushtuesit nazifashistë dhe transmetimin te brezat e rinj, të vlerave, sakrificave dhe vetëmohimit të treguar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare”

79 vite më parë më 29 Nëntor 1944 Shqipëria u çlirua nga pushtuesit nazifashistë ndaj dhe në këtë ditë feste vishet me flamurin kuqezi.

Çlirimi i Shqipërisë është një moment historik dhe konsiderohet si një nga ngjarjet kulnore në historinë e Shqipërisë. Ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme, Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë. Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjeto-amerikane. Në momentin historik populli shqiptar, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo që jetonte në trojet e tij etnike u bashkua me forcat e lirisë kundër atyre të errësirës. Në bazë të kësaj lufte e sakrificave që bëmë, ne siguroam jo vetëm pavarësinë e Shqipërisë por të drejtën e shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje e të shqiptarëve kudo që jetojnë, të drejtën për të qëndruar në trojet e tyre etnike. Kjo ishte fitorja e dytë më e madhe në historinë tonë kombëtare, pas shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së Flamurit në Vlorë.

TIRANA KRYEQENDRA E FESTAVE TË NËNTORIT

Çlirimit të plotë të Shqipërisë nga okupatori nazifashist i parapriu çlirimi i Tiranës më 17 nëntor 1944. 79 vjet pas kësaj date historike, në Ditën e



Çlirimit të Tiranës, kryetari i bashkisë, Erion Veliaj nderoi veteranët e Luftës për kontributin e tyre në mbrojtjen e atdheut nga pushtuesit nazifashistë. Gjatë fjalës së mbajtur në ceremoninë e zhvilluar për 79-vjetorin e çlirimit të kryeqytetit, Veliaj u shprehu mirënjohjen e veçantë atyre.

“Çlirimtarët e luftës, ata që i dhanë Tiranës, kryeqytetit tonë, lirinë, të paasistuar nga forcat ruse,



që ndihmuan shumë kryeqytete të tjera, meritojnë sot të gjithë respektin, të gjithë përlujen dhe mirënjohjen tonë. Më vjen mirë që ajo Tiranë për të cilën luftuan shumë të rinj atëherë, sot është Kryeqyteti European i Rinisë apo i Sportit. Ndaj për të gjithë ata të rinj të asaj kohe, që sot janë 90 e kusur vjeç dhe do të nderohen, më vjen mirë që kemi këtë organizim, për të reflektuar pak dhe për të dedikuar respekt dhe mirënjohje për të gjithë ata që na bënë sot krenarë dhe u rreshtuan në anën e duhur të historisë,” u shpreh Veliaj.

Kreu i bashkisë kishte edhe një thirrje për t'u bashkuar në emër të kësaj dite dhe sakrificës së të rënëve për liri.

“Sot është gjithashtu një moment për të reflektuar. Ne duhet të kuptojmë pse kombi ynë akoma vazhdon i përçarë? Pse duhet të bëjmë homazhe veç e veç? Pse nuk mblidhemi dot të respektojmë dhe të nderojmë ata njerëz? Pse disa nga ne hyjnë nga dera dhe disa të tjerë nga kangjellat dhe dritarja? Çfarë ka ndodhur? Çfarë është ky mallkim që nuk na ndahet? Si ka mundësi pas 79 vitesh ne vazhdojmë akoma të përçarë. Ne duhet ta fitojmë përditë betejën për një Tiranë europiane dhe të jetojmë përditë për të justifikuar atë sakrificë,” u shpreh mes të tjerash Veliaj.

KRYETARI I OBVL, KOLONEL SOTIR BUDINA NDEROHET NGA KRYEBASHKIAKU VELIAJ

Në këtë ditë të veçantë, kryebashkiaku Veliaj nderoi “për kontributin e pashembullt në luftën për liri, mbrojtjen e atdheut nga pushtuesit nazifashistë dhe transmetimin te brezat e rinj, të vlerave, sakrificave dhe vetëmohimit të treguar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare”, 10 veteranë të LANÇ. Në këtë ditë të shënuar, kryebashkiaku Veliaj vlerësoi me Çertifikatë Mirënjohje edhe kryetarin e OBVL kolonel Sotir Budinën.

Sotir Ilo Budina, ka lindur në qytetin e Korçës më 14.03.1926. Ka marrë pjesë në lëvizjen Antifashiste që në vitin 1939 e në vijim si anëtar aktiv i njësiteve guerrile. Ka qenë pjesëmarrës në luftën për çlirimin e Tiranës si partizan i Brigadës 4 S. Gëzon statusin e invalidit të LANÇ. ËSHTË KRYETAR I OBVL

Po ashtu, së bashku edhe me personalitete të tjera të politikës dhe familjarë të dëshmorëve, si edhe me drejtues të OBVL, Veliaj kreu homazhe tek Ushtari i Panjohur në nderim të heronjve që dhanë jetën për Çlirimin e Tiranës.

Tefta Cami: T'i mbrojmë vlerat dhe gjakun e derdhur gjatë Luftës Nacional Çlirimtare

E ftuar nga kryesia e OBVL për të marrë pjesë në veprimtarisë festive me rastin e 79-vjetorit të çlirimit të Tiranës, Tefta Cami përcolli këtë mesazh gjatë drekës së shtruar për vetyarënet nga kryebashkiaku Veliaj.

“Si pasardhëse e katër brezave Dëshmorë të Atdheut, të vranë në lufta si komandanta çetash kundër forcave osmanllie të Hajredin Pashës, kundër forcave pushtuese serbe-bullgare gjatë Luftës të Parë Botërore dhe kundër forcave pushtuese nazifashiste gjatë Luftës të Dytë

Botërore për mbrojtjen e trojeve shqiptare, si dhe pasardhëse e veteranëve të LANÇ, ju përsëndes të gjithë të pranishmëve, drejtues e veteranë dhe pasardhës të veteranëve!



Festimi i Ditës së Çlirimit të Tiranës është një ngjarje e madhe historike, që u realizua me sukses nga forcat partizane kundër forcave pushtuese nazifashiste! Do të ishte mirë që, në këtë ditë të shënuar, të merrnin pjesë të rinjtë, që ta njohnin Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare si një nga epokat e lavdishme të popullit shqiptar, që ta duan mëmëdheun e të punojnë për begatimin e vendit dhe ta mbrojnë Shqipërinë nga çdo rrezik!

Ngjarjet në Banjsk të Mitrovicës në Kosovë të sulmit të forcave paramilitare të Republikës së Serbisë janë një këmbanë alarmi për gjithë shqiptarët për rrezikun që mund të ndodhë.

T'i mbrojmë vlerat e kontributet e mëdha dhe gjakun e derdhur gjatë Luftës Nacional Çlirimtare! Të mbrojmë botimet e filmat dhe dokumentarët, si dhe simbolet e Luftës, që brezi i ri të njohë e të mbrojë këto vlera historike të lavdishme!

Besoje, se Bashkia e Tiranës do të vazhdojë ta zbukurojë Tiranën me përmendore që nga mbretëresha Teuta e Ilirisë, me Donikën e Skënderbeut e me gjithë emblemat e shqiptarisë të të gjitha epokave si kryeqytet i gjithë shqiptarëve (ideologun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashërin e kryetarin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit Iliaz pash Dibra, Sami e Naim Frashëri, Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi, Fan Noli, Asdrenit, Aleksandër Xhuvani, Parashqevi Qiriazi apo motrat Qirjazi, Gjergj Fishta, Lazgush Poradeci, Mitrush Kuteli, disa heronjë e personalitete të shquara të Kosovës e viseve të tjera shqiptare etj., si Adem Demaçi e Arbër Xhaferri...).

Lavdi dëshmorëve e veteranëve të Tiranës! Lavdi dëshmorëve e heronjve të të gjitha luftave të kombit shqiptar!